






# **Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri**

**Raporti i Logos**  
Qershor 2017

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1	Znj. Beatrice Ollerenshaw	Kryetare	
2	Profesor John Baldock	Anëtar	
3	Dr Alketa Grepcka	Anëtare	

Data: 1-2 qershor 2017

## **Përmbajtja**

Konteksti i këtij vlerësimi .....	2
Raporti përmbledhës.....	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	6
Raporti i detajuar.....	9
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi.....	9
Fusha e vlerësimit 2: Burimet.....	14
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula .....	18
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	23
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre .....	31
Lista e dokumenteve .....	35

## Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, të hyra në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi i jashtëm institucional është një proces i vlerësimit me ekspertë të jashtëm, ku çdo grup ekspertësh përbëhet nga ekspertë të Mbretërisë së Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja, dhe nga ekspertë shqiptarë të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së Standardeve nga IAL-ja, por edhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët, se si IAL-ja i përmbush Standardet. Ky raport, i ndihmon gjithashtu IAL-të që të identifikojnë përparësitë për përmirësime (procesi që ofruhet e arsimit të lartë zbatohet për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar nën pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre.

Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave më të mira, rekomandimet, pohimet e veprimtarisë në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush Standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: Standardet janë përmbushur plotësisht; Standardet janë përmbushur kryesisht; Standardet janë përmbushur pjesërisht; ose Standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

**Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht**  
**Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**  
**Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**  
**Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja ka siguruar ekspertë mbështetës për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm duke siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe për korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen më poshtë.

## Konteksti i këtij vlerësimi

Shkolla Lartë Private “Logos” (Kolegji Universitar “Logos”) është pjesë e një Fondacioni të themeluar nga Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe të gjithë Shqipërisë, nën mbikëqyrjen e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Në vitin 2000, për të mbështetur nevojën për aftësi profesionale në Shqipëri, Institucionit të Formimit Profesional “Fryma e Dashurisë” iu dha një licencë, që ishte pararendës i zhvillimit të Logos, i cili vepron në një nivel më të lartë akademik. Fondacioni daton që prej vitit 2008 (kur u themelua si Instituti i Trajnimit Profesional) dhe në vitin 2011 u lejua të ndryshonte emrin e tij në Kolegjin Universitar “Logos”. Sipas legjislacionit 2015, Logos do të ketë statusin e një Kolegji Universitar. Në vitin 2014, Ministria i pezullojë institucionit Kolegji Universitar “Logos” regjistrimin e studentëve të rinj, por pas dy muajsh dhe në janar të vitit 2015 u dha autorizim që Kolegji Universitar “Logos” të ofrojë programe të ciklit të dytë Master Profesional. Rekrutimi i tyre u pezullua për vitin akademik 2016-17, ndërsa u pohuan çështje të ndryshme rregullatore.

Fondacioni është një organizatë private jofitimprurëse, Kryepeshkopi është Presidenti i Kolegjit Universitar “Logos” dhe Kisha zotëron pronën në ushtron veprimtarinë akademike Logos PHS. Ajo ndodhet në qendër të Tiranës në një pallat shumëkatësh, të cilin e ndan me organizata të tjera. Ka plane në të ardhmen të transferohet në një vend prej 8 hektarësh jashtë Tiranës, por kampusi nuk është ndërtuar ende dhe do të varet nga fakti i themelimit të një fakulteti të tretë, me qëllim kërkimin e statusit të universitetit.

Ka dy fakultete, Fakultetin e Ekonomisë, i cili përfshin Departamentet e Menaxhimit të Biznesit, Financës dhe Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Turizmit; dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara që përfshin Departamentet e Informatikës së Aplikuara dhe për Teknikën e Lartë Laboratorësh Mjekësorë (gjithashtu të referuara si Departamenti i Teknikave të Avancuara në Laboratorin Mjekësor) dhe një Qendër Kërkimi dhe Zhvillimi Shkencor. Njësitë drejtuese dhe administrative janë Rektorati, Kancelari, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Financa dhe Arkivi, Marrëdhëniet me Jashtë, Sekretaria dhe Arkivi, Senati Akademik, biblioteka dhe mbështetja e TI-së.

Kolegji Universitar “Logos” ofron pesë programe të ciklit të parë dhe dy programe të ciklit të dytë; këto të fundit janë programe të nivelit Master Profesional. Programet e ciklit të parë janë programe trevjeçare Bachelor në Informatikë të Aplikuara, në Teknikë e Lartë në Laboratorët Mjekësorë, Menaxhimi i Turizmit, Financë dhe Kontabilitet dhe Menaxhim Biznesi. Programet e ciklit të dytë zgjasin 1-1.5 vjet dhe janë në Financë dhe Kontabilitet dhe Teknikë e Lartë në Laboratorët Mjekësorë.

Ka 336 studentë të regjistruar në programet e ciklit të parë dhe 39 në ciklin e dytë në vitin akademik 2016-17. Shumica e studentëve janë shqiptarë, por disa prej tyre janë nga vende të tjera në rajon, veçanërisht nga Kosova. Programet e ciklit të parë janë shtuar gjatë tre viteve të fundit (nga gjithsej 207 studentë në vitin 2014-15 në 336 studentë në vitin 2016-17), por numri i studentëve në programet e ciklit të dytë janë pakësuar (nga 46 në 39).

Ka 41 vetë staf akademik me kohë të plotë dhe 20 me kohë të pjesshme, të mbështetur nga 17 punonjës administrativë dhe mbështetës. Anëtarët e stafit akademik kanë të paktën një diplomë Master, 18 kanë PhD dhe 10 kanë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Vetëm një nuk është shtetas shqiptar. Numri i stafit është shtuar gjatë tre viteve të fundit, pasi janë larguar 11 persona staf akademik dhe janë emëruar 50 të tjerë. Ngarkesa e zakonshme mësimore është 8.5 orë në javë.

## Raporti përmbledhës

Raporti i Vetëvlerësimit (RVV) për Kolegji Universitar “Logos” u përgatit nga një grup prej gjashtë vetash, që përfshinte edhe një përfaqësues të studentëve, përzgjedhur në bazë të ekspertizës dhe objektivitetit të tyre. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu dha akses në dokumentacion dhe në të dhënat statistikore dhe u përkushtuan që procesi të ishte sa më transparent të ishte e mundur. Projektraporti i RVV-së u diskutua në të gjitha departamentet, si dhe me studentët e ciklit të parë dhe të dytë dhe ata që po zhvillonin praktikën profesionale. Versioni përfundimtar u mbështetet te reagimet dhe komentet e dërguara.

RVV i përmbahet fushave të vlerësimit të kërkuara dhe trajton të gjitha standardet; dokumentacioni u vu në dispozicion dhe u mor si referencë, megjithëse jo të gjitha janë siguruar fillimisht në gjuhën angleze. RVV përqendrohet në përputhshmërinë mes e veprimtarisë së institucionit me Statutin, por nuk ofron gjithmonë dëshmi se si kjo realizohet në praktikë në veprimtarinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, dhe për këto dëshmi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm duhej të mbështetej në mënyrë të ndjeshme në takimet që realizoi. RVV përfshin një analizë SWOT, që sugjeron disa fusha dobësish (në projekte ndërkombëtare, botime, infrastrukturë për jetën shoqërore dhe kulturore, dhe qëndrueshmëria e disa strukturave), por në thelb nuk arrin të bëjë lidhjen midis tyre dhe standardeve, dhe sugjeron që të gjitha fushat e vlerësimit janë përmbushur.

Vizita u zhvillua gjatë dy ditëve, më 1-2 qershor të vitit 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të arsimit të lartë nga Mbretëria e Bashkuar dhe një anëtar me përvojë nga stafi i një institucioni shqiptar i arsimit të lartë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit, nga ana e APAAL-it dhe gjithashtu u siguroa një person për mbajtje shënimesh. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka shqyrtuar RVV-në dhe dokumentet mbështetëse të marra tetë javë përpara vizitës së vlerësimit. Në to përcaktoheshin strukturat, politikat dhe procedurat që mbështesin veprimtarinë akademike të Kolegjit Universitar dhe i mundësuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm që t'i vlerësojë ato për sa i përket Standardeve Shtetërore Shqiptare të Cilësisë. Dokumentet përfshinin rregullat dhe statutet që pasqyrojnë bazën ligjore për qeverisjen e Logos PHS, hartimin e kontratave të punës për stafin dhe informacionin për programet e ofruara. Faqja publike e internetit referohej në RVV dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e aksesoi atë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kërkoi dokumentacion të mëtejshëm përpara vizitës, përfshirë përkthimin e disa dokumenteve të ofruara në gjuhën shqipe, si dhe materiale shtesë, gjatë vizitës, për t'i mundësuar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të shqyrtojë provat për mënyrën se si Kolegjit Universitar “Logos” i trajton standardet.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e lartë, studentët, pedagogët, stafin administrativ dhe ndihmës, si dhe alumni, partnerët e jashtëm dhe punëdhënësit gjatë vizitës së vlerësimit. Diskutimi i mundësoi grupit të vlerësimit që të qartësojë procedurat, përgjegjësitë dhe pikëpamjet e Kolegjit Universitar. U mbajtën shënime në të gjitha mbledhjet. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi ambientin, pa sallat e leksioneve dhe seminareve, laboratorët, zyrat dhe bibliotekën.

Kolegji Universitar “Logos” administrohet në bazë të Statutit dhe Aktit të Themelimit, që e lidh atë me Fondacionin e mbikëqyrur nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë. Ka një Rektor, një strukturë fakulteti të drejtuar nga dekanët, brenda së cilës janë departamentet dhe një Qendër për Zhvillimin dhe Kërkimin Shkencor. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi marrëdhëniet midis këtyre njësive, stafit kryesor drejtues (Rektorin, Zëvendësrektorin dhe Kancelarin), dhe organeve vendimmarrëse, përfshirë Senatin Akademik, Këshillin e Etikës dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC). Studentët janë të përfaqësuar në Bordet dhe Këshillat dhe ka një Këshill Studentor. Plani 2012-2017 i shqyrtuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm tregoi se Kolegji Universitar “Logos” i është përkushtuar zhvillimit të konsiderueshëm në mënyrë që të trajtonte

Standardet Shtetërore. Një grup pune po harton një plan të ri për vitin 2017-2021, i cili do të miratohet sipas Statutit të rishikuar në përputhje me legjislacionin e vitit 2015. Kjo parashikon një Bord të ri të Administrimit brenda strukturës së Fondacionit, që do të përbëhet nga një anëtar i stafit akademik dhe katër përfaqësues të jashtëm.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i mendimit se strukturat janë në përputhje me Statutin dhe se në nivel Fakulteti dhe Kolegji Universitar zhvillohen diskutime. Përfaqësimi i studentëve në Bordet kryesore, duket se është i efektshëm dhe ka shembuj të opinionit të studentëve, që çojnë në përmirësime të shërbimit të ofruar. Fondacioni duket se është bujar me mbështetjen e tij financiare për veprimtaritë mësimore të Kolegjit Universitar "Logos" dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk evidentoi dëshmi se ndikon negativisht në lirinë akademike. Ka një lidhje me Universitetin e Pireut jashtë Shqipërisë dhe stafi ka disa mundësi për t'u angazhuar në projekte kërkimore dhe konferenca në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, por veprimtari të tilla nuk mbështeten financiarisht dhe nuk ka mobilitet studentor.

Kolegji Universitar "Logos" është financiarisht i qëndrueshëm, me pasqyrat që auditohen nga Fondacionit; prona është në pronësi të Kishës. Burimet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies përfshijnë sallat mësimore të përshtatshme për qëllime studimore, salla të pajisura me kompjutera dhe softuer për informatikë dhe laboratorë të përshtatshëm për analizën e mostrave mjekësore. Biblioteka ofron një numër relativisht të vogël të librave në gjuhën shqipe dhe vetëm një përqindje e vogël e studentëve janë regjistruar për të marrë libra në bibliotekë. Përdorimi i burimeve të bibliotekave elektronike është shumë i kufizuar.

Ka procese të qarta për emërimin dhe dokumentacionin lidhur me stafin, që përcakton sjelljet e duhura të stafit, por stafi ka qenë një çështje që ka sjellë shqetësime. Kolegji Universitar "Logos" dëshiron të zhvillojë kualifikime, në veçanti për të marrë grada shkencore, dhe e lehtëson stafin me kohë të plotë nga mësimdhënia, për të ndërmarrë studime PhD. Stafi me kohë të pjesshme është gjithashtu i punësuar në rolet përkatëse profesionale, në pozicionet e teknikëve të laboratorëve mjekësorë dhe mund të sjellë përvojë të re në mësimdhënien e tyre.

Strukturat për programet e studimit përcaktohen në rregulloret dhe dokumentacionin e kurrikulës. Strukturat e programeve janë në përputhje me Procesin e Bolonjës, duke përdorur sistemin ECTS dhe ndahen në module që kanë kërkesat e tyre të mësimdhënies dhe vlerësimit brenda kornizës së përgjithshme. Studentët pajisen me një Suplement të Diplomës. Programet zhvillohen nga profesori dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani. Studentët nxiten të bëjnë pyetje në seminare dhe leksione dhe stafi gjen kohën, për të ndihmuar ata që e kanë vështirësi me kuptimin e një teme. NjSBC-ja analizon reagimet dhe opinionet e studentëve nga anketimet, por nuk ka ndonjë plan veprimi të lidhur me të dhe asnjë mekanizëm për të ndjekur raportin, që të sigurohet zbatimi i përmirësimeve. Zhvillimi i stafit për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies varet nga iniciativa e individëve, pasi nuk ka një proces formal për përkrahje. Provimet nuk korrigjohen në mënyrë të fshehtë.

Punësueshmëria e studentëve ndërtohet në programe e studimit, nëpërmjet praktikave profesionale, dhe punëdhënësit janë shumë pozitivë për njohuritë që studentët dhe të diplomuarit e Kolegjit Universitar "Logos" sjellin në vendin e punës. Studentët mbështeten nga Zyra e Këshillimit të Karrierës (ZKK), për të gjetur vend pune dhe punëdhënësit njoftojnë ZKK-në për vendet e lira. Punësimi i të diplomuarve monitorohet, por nuk ka dëshmi të informacionit që përdoret për të mbështetur zhvillimin e programeve, dhe, të diplomuarit dhe punëdhënësit nuk kanë mundësinë të sugjerojnë ndryshime.

Kërkimi menaxhohet në mënyrë institucionale nga Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit Shkencor, mbështetur nga planet e departamenteve. Ka dëshmi të angazhimit të stafit në projektet kërkimore dhe në botime, dhe Kolegji Universitar "Logos" publikon revistën e vet

shkencore, që përfshin të dhëna për kërkimet shkencore. Veprimtaria individuale kërkimore, veçanërisht për stafin që studion për Doktoraturë, është më domethënëse sesa projektet institucionale. Nuk ka fonde për veprimtari kërkimore të stafit, për shembull për të mbështetur udhëtimin jashtë vendit ose pjesëmarrjen në konferencë dhe nuk ka fare fonde për të mbështetur mobilitetin e studentëve.

Kërkesat e pranimit janë shpallur qartësisht në faqen e internetit dhe studentët e rinj nënshkruajnë një kontratë shërbimi. Ka plane për të zhvilluar një bazë të të dhënave të studentëve, për të përfshirë një ndërfaqe për stafin dhe studentët. Faqja e internetit përmban informacione për kriteret dhe procesin e pranimeve, programet dhe Kolegjin në tërësi. Ka një skemë bursash në bazë të performancës akademike dhe nevojave të mirëqenies, dhe po ndërmerren hapa për zhvillimin e infrastrukturës për aktivitetet kulturore dhe sportive të studentëve. Këshilli Studentor është aktiv dhe efektiv në sigurimin e ndryshimeve që iu përgjigjen shqetësimeve të studentëve, por nuk ka mbështetje financiare për aktivitetet e këtij këshilli.

Në arritjen e vlerësimeve të tij, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy fusha ku Logos PHP ishte i ndërgjegjshëm se zhvillim i mëtejshëm është i domosdoshëm dhe ka pohuar veprimet e propozuara të Kolegjit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka bërë edhe gjashtë rekomandime që Kolegji Universitar "Logos" t'i konsiderojë si një mjet, për të siguruar më tej cilësinë dhe Standardet e programeve të tij dhe përvojën e mësimnxënies të studentëve të vet.

Kolegji Universitar "Logos" ndërmori vlerësimin në përputhje me udhëzimet e APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e vlerëson angazhimin dhe bashkëpunimin e Kolegjit Universitar "Logos" gjatë procesit të vlerësimit, duke përfshirë ofrimin e dokumenteve të kërkuara para dhe gjatë vizitës dhe punën e dy kolegëve si përkthyes gjatë vizitës.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht në dy fusha dhe janë përmbushur kryesisht në tre fusha. Në bazë të kësaj, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Standardet e cilësisë përgjithësisht janë përmbushur kryesisht.



# Përmbledhje e gjetjeve

## Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

## Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e mbështetjes financiare për veprimtaritë kërkimore, si udhëtimi dhe pjesëmarrja në konferenca dhe ofrimi shumë i kufizuar i mundësive të mobilitetit për stafin dhe studentët (pikat 1.12, 4.24, 4.25 dhe 4.27; **Kapitulli III Standardi III.4, Kapitulli II Standardi I.1, Kapitulli II Standardet I.2, Kapitulli II Standard I.6**)
- mungesa e angazhimit në mundësitë e ofruara nga skema Erasmus për mobilitetin e studentëve (pikat 1.12, 4.24 dhe 4.25, **Kapitulli III Standardet III.4, Kapitulli II Standardi I.3**)
- furnizimi i kufizuar i librave kryesorë në gjuhën shqipe, akses i kufizuar në burimet e bibliotekave elektronike dhe përdorimi i kufizuar i bibliotekës nga studentët (pikat 4.5, 4.4 dhe 5.5, **Kapitulli I Standard II.1, Kapitulli I Standardi III.5**)
- nuk ka sistem për sekretimin e fletëve të provimeve (pika 4.15; **Kapitulli I Standard II.2**)
- mungesa e një procesi formal për sigurimin dhe monitorimin e përmirësimit të cilësisë bazuar në të dhënat e anketimit të studentëve dhe të dhënat e punësimit të të diplomuarve, dhe mungesa e një procesi që punëdhënësit dhe të diplomuarit, të japin komentet dhe reagimet e tyre, në mbështetje të zhvillimit të programeve (pikat 4.20, 4.18 dhe 4.19, **Kapitulli I Standard II.3, Kapitulli I Standardi II.4**)
- mungesa e mbështetjes financiare për aktivitetet e Këshillit Studentor (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**).

## Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- që Kolegji Universitar “Logos” të krijojë fonde me të cilat mund të mbështeten stafi dhe studentët, për të përfituar nga mundësitë e mobilitetit, që mund të ofronin marrëveshjet e tyre të bashkëpunimit dhe aktivitetet e konferencës, brenda gjashtë muajve nga marrja e raportit përfundimtar (pikat 1.12, 4.24, 4.25 dhe 4.27; **Kapitulli III Standardet III.4, Kapitulli II Standardet I.1, Kapitulli II Standardet I.2, Kapitulli II Standardet I.6**)
- që Kolegji Universitar “Logos” të mbështesë aplikimet për të përfituar nga mundësitë e ofruara nga përfshirja e Shqipërisë në skemën e Erasmus, për sa in përket mobilitetit të studentëve, brenda 12 muajve nga marrja e raportit përfundimtar (pikat 1.12, 4.24 dhe 4.25, **Kapitulli III Standardi III.4, Kapitulli II Standardi I.3**)
- që Kolegji Universitar “Logos” të zbatojë një strategji për të përmirësuar shërbimin që ofron biblioteka dhe për të siguruar përdorimin e njëtrajtshëm si të fondit të librave të shtypur (veçanërisht në gjuhën shqipe) ashtu edhe të librave elektronike, brenda 9 muajve nga marrja e raportit përfundimtar (pikat 4.5, 4.4 dhe 5.5, **Kapitulli I Standardi II.1, Kapitulli I Standardi III.5**)
- që Kolegji Universitar “Logos” të zbatojë sekretimin anonim të provimeve menjëherë pas marrjes së raportit përfundimtar (pika 4.15; **Kapitulli I Standardi II.2**)
- që Kolegji Universitar “Logos” të krijojë një proces të monitoruar nga NjSBC-ja, për përmirësimin e programeve në përgjigje të të dhënave të anketimit të studentëve, të

dhënave të punësimit dhe reagimeve nga punëdhënësit dhe alumni, brenda 12 muajve nga marrja e raportit përfundimtar (pikat 4.20, 4.18 dhe 4.19, **Kapitulli I Standardi II.3, Kapitulli I Standardi II.4**)

- që Logos të sigurojë mbështetje financiare për aktivitetet e Këshillit Studentor brenda gjashtë muajve nga marrja e raportit përfundimtar (pika 5.7, **Kapitulli I Standardi III.7**).

## **Pohim i veprimeve të ndërmarra**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e mëposhtëm të ndërmarra:

- zhvillimi i vazhdueshëm i sistemit elektronik të të dhënave të studentëve dhe aksesit në informacionin në internet (pikat 2.7 dhe 2.11; **Kapitulli III Standardi VII.1, Kapitulli III Standardi V.2**)
- ristrukturimi i hapësirës në katin e dhjetë që të përdoret për aktivitete sociale dhe kulturore, në përfitim të studentëve (pika 5.8; **Kapitulli I Standardi III.8**).

## **Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi**

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin janë **përbushur kryesisht.**
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht.**
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht.**
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht.**
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur kryesisht.**

## **Gjykimi i përmbledhur**

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Logos PHS, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur kryesisht.**

## Raporti i detajuar

### Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi

1.1 Rregullimi i brendshëm i Kolegjit Universitar “Logos” drejtohet nga statuti i vet, që përcakton bazën e tij ligjore si institucion privat i arsimit të lartë sipas legjislacionit shqiptar, që ofron programet e arsimit të lartë të ciklit të parë dhe të dytë. **[3.1; M1]** Në përputhje me legjislacionin shqiptar, statutet përcaktojnë misionin dhe objektivat e institucionit, së bashku me strukturën e tij akademike dhe administrative. **[3.1]** Statutet aktuale janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë nr. 9471. **[RVV; M1]** Kolegji Universitar ka konceptuar edhe një version të ndryshuar të Statutit, për të siguruar përputhshmërinë me ligjin e ri për arsimin e lartë nr. 80 (2015). **[RVV fq.9]** Kolegji Universitar “Logos” gjithashtu ka një grup të plotë Rregulloresh të Përgjithshme që rregullojnë veprimtarinë akademike dhe kërkimore të tij, pranimet, mësimdhënien dhe vlerësimin, dhënien e diplomave dhe menaxhimin e cilësisë së programeve të studimit. **[3.3]** Senati, i mbështetur në këshillimin nga Rektorati dhe Këshilli i Etikës, shqyrton rregullisht Rregulloret e Përgjithshme dhe i ndryshon, nëse është e nevojshme. **[RVV fq. 9]** Rektori i pohoi Grupit të Vlerësimit të Jashtëm se gjatë vitit 2016 Senati u mblodh në shumë raste për të shqyrtuar dhe përmirësuar Statutin dhe Rregulloret e Përgjithshme në përgatitje për të njohur dhe zbatuar dispozitat e ligjit të ri 2015 për arsimin e lartë. **[M1; M2]** U pohua se të gjitha ndryshimet u diskutuan gjerësisht brenda Kolegjit Universitar dhe se studentët u përfshinë në këtë proces. **[M1] [Kapitulli III Standardi I.1]**

1.2 Struktura dhe organizimi i menaxhimit të Kolegjit Universitar “Logos” janë të përcaktuara në Statutet dhe Rregulloret e Përgjithshme. **[3.1; 3.3]** Bordi i Administrimit është organi më i lartë vendimmarrës i Kolegjit Universitar dhe mbikëqyr dhe miraton aktivitetet strategjike, financiare, menaxheriale dhe administrative; ai përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar nga Drejtuesi i Fondacionit, një prej të cilëve është anëtar i stafit akademik dhe katër janë persona të jashtëm me përvojë të përzgjedhur nga universitete dhe organe të tjera publike. **[M1; 3.1; RVV fq.9]** Rregulloret e Përgjithshme caktojnë Rektorin dhe Senatin si përgjegjës për çështjet akademike. **[3.3: 8]** Rektori është drejtuesi ekzekutiv përgjegjës për menaxhimin e Kolegjit Universitar dhe caktohet me vendim të Drejtuesit të Fondacionit për një periudhë tre-vjeçare me të drejtë riemërimi. **[3.3: 18]** Senati është një autoritet kolektiv vendimmarrës i Kolegjit Universitar dhe vendos për çështjet mësimore dhe shkencore, siç janë planet zhvillimore, miratimi i programit, drejtimi dhe mbikëqyrja e mësimdhënies dhe vlerësimit, dhe mund të riemërohet. **[3.3: 8]** Senati përbëhet nga rektori, i cili e kryeson atë, së bashku me gjashtë anëtarë të stafit akademik të zgjedhur nga i gjithë stafi akademik dhe një përfaqësues i studentëve zgjedhur nga studentët. Senati mblidhet së paku një herë në dy muaj, por më shpesh nëse është e nevojshme. **[3.1: 13; M1]** Rektorit i raportojnë dekanët e dy fakulteteve që ofrojnë programe të nivelit Bachelor dhe Master (Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, Fakulteti i Ekonomisë) dhe Përgjegjësit e Departamenteve Akademike (Financë dhe Kontabilitet, Menaxhim Biznesi, Menaxhim Turizmi, Informatikë e Aplikuar, Teknik i Lartë për Laboratorët Mjekësorë) dhe Drejtuesi i Qendrës për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin. **[RVV fq. 14; 4.5]** Administrimi i Kolegjit Universitar “Logos” mbikëqyret nga Kancelari, i cili i raporton Rektorit dhe Bordit të Administrimit. **[3.1: 20]** Secili nga fakultetet ka Këshillin e vet. **[3.1.16]** Ka gjithashtu një Këshill të Administrimit që përbëhet nga anëtarë të stafit akademik të zgjedhur nga secili prej pesë departamenteve në Kolegjin Universitar dhe një anëtar student të zgjedhur nga Këshilli i Studentor. Këshilli i Administrimit është një forum që shqyrton dhe diskuton shpërndarjen e burimeve kryesore në Kolegjin Universitar, përfshirë buxhetin vjetor dhe raportin vjetor financiar. **[3.1: 15]** Kolegji Universitar ka Këshillin e Etikës që i raporton Rektorit për çështjet që i referohen atij. **[3.1: 16]** Rektori kryeson një Bord të Cilësisë që mbikëqyr vlerësimin periodik të programeve dhe stafit. **[3.1: 17]** Provat që shqyrtoi dhe u vu në dijeni Grupi i Vlerësimit të Jashtëm treguan se këto aranzhime menaxheriale dhe administrative

funksiononin në mënyrë të efektshme dhe efikase, dhe në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e Përgjithshme. **[Kapitulli III Standardi I.2]**

1.3 Dokumentacioni që shqyrtoi Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, së bashku me provat për të cilat u vu në dijeni nga stafi akademik dhe administrativ, si edhe nga studentët, pohuan se Senati dhe bordet e tjera të përfshira në qeverisjen dhe menaxhimin e Kolegjit Universitar mbledhen rregullisht dhe u mundësohen shërbimet e përshtatshme. Kjo u lejon atyre të marrin vendime siç përcaktohet në Statutet dhe Rregulloret e Përgjithshme. **[4.1- 4.4; Dokument shtesë 4a; M1; M2; M4; M5]** Studentët dhe stafi treguan se pikëpamjet e tyre merren parasysh para marrjes së vendimeve. **[M4; M7]** Si Rektori, ashtu edhe pjesëtarë të tjerë të stafit pohuan se gjatë vitit 2016, Senati dhe Këshilli i Administrimit u mbledhën më shpesh nga sa parashikohej, për t'u përgatitur për riakreditim sipas ligjit të ri për arsimin të lartë nr. 80 (2015) **[M1; M2] [Kapitulli III Standardi I.3]**

1.4 Kolegji Universitar "Logos" monitoron rregullisht cilësinë dhe efektivitetin e programeve të tij, të mësimdhënies dhe ecurinë e studentëve të vet. **[3.1: 17; 8.5]** Njësia e Sigurimit të Brendshme Cilësisë (NjSBC) është përgjegjëse për vlerësimin periodik dhe raportin tek Bordi për Cilësinë në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimdhënies dhe pjesëmarrjen dhe ecurinë e studentëve. **[3.1: 17; 8.5]** Gjithashtu i dorëzon APAAL-it raporte dhe kërkesa për akreditimin e programeve. **[3.6; RVV fq.12]** NjSBC-ja ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e mbajtura nga Kolegji Universitar. **[3.6]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi një sërë raportesh të përpiluara nga NjSBC-ja dhe diskutoi me disa anëtarë të stafit të tij rreth veprimtarive të kësaj njësie, që përfshijnë monitorimin e cilësisë së të mësuarit dhe përcaktimin se ku kërkoheshin ndryshime në qasjen ose sigurimin e më shumë burimeve. **[8.9-12; M2; M8]** Kolegji Universitar ka filluar të angazhohet me aplikime për financim në programet evropiane, duke përfshirë bashkëpunimin me një universitet grek për turizmin dhe një konferencë të financuar nga Erasmus, për lirinë e shprehjes dhe të drejtave të njeriut. **[M1] [Kapitulli III Standardi I.4]**

1.5 Kolegji Universitar ka funksionuar në kuadrin e një plani strategjik të zhvillimit që nga viti 2012. "Plani Strategjik për Zhvillimin e Kolegjit Universitar "Logos": Prioritetet dhe Synimet 2012-2017" përcakton një sërë objektivash thelbësore që përfshijnë: përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve akademike dhe të mësimdhënies; rritjen e numrit të studentëve dhe stafit; zhvillimin e veprimtarisë kërkimor në bashkëpunim me institucionet e tjera në Shqipëri, Evropë dhe më gjerë; zhvillimi i bazës së të dhënave të studentëve, për të monitoruar ecurinë dhe progresin e studentëve; dhe forcimin e partneriteteve bashkëpunuese me punëdhënësit. **[3.2; RVV fq.13]** Është shënuar progres në arritjen e këtyre synimeve dhe është monitoruar në Raportet Vjetore **[5.1; dokument shtesë 4a]** Në veçanti, madhësia fizike e Kolegjit Universitar është dyfishuar që nga viti 2012, si edhe numri i studentëve dhe stafit është shtuar. **[5.1]** Në kohën e vlerësimit, sapo kishte përfunduar Plani i ri Strategjik 2017-2022, pas diskutimeve të gjera dhe konsultimeve brenda Kolegjit Universitar. **[3.2; dokument shtesë 4.a]** Kolegji Universitar "Logos" ka zhvilluar gjithashtu partneritete në kërkim shkencor dhe mësimdhënie me një sërë universitetesh, veçanërisht me Universitetin e Pireut. **[M2; Dokumente shtesë]** Janë bërë plane për krijimin e një Fakulteti të ri të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, i cili do të ofronte tre programe studimi. **[15: 2-3, M1. [Kapitulli III Standardi I.5]**

1.6 Çdo semestër dhe çdo vit, Rektori i raporton Senatit dhe Bordit të Administrimit mbi veprimtaritë financiare, mësimore dhe kërkimore të Kolegjit Universitar. **[3.6]** Kolegji Universitar raporton çdo vit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për gjendjen e tij financiare, për stafin e saj, performancën e studentëve në secilin nga programet e tij, dhe në përgjithësi për veprimtarinë akademike. **[3.1 Neni 8; 5.1]** Raporti vjetor diskutohet në një takim të hapur të stafit administrativ dhe akademik dhe studentëve dhe bëhen ndryshime, nëse është e nevojshme. **[3.1: nenet 13, 14; RVV fq.13] [Kapitulli III Standard I.6]**

1.7 Neni 7 i Statutit të PHS Logos parashikon autonominë akademike të Kolegjit Universitar, për hartimin e programeve të studimit, për rekrutimin e stafit dhe studentëve, për angazhimin në kërkimin shkencor, për atashimin në shoqata, për nënshkrimin e marrëveshjeve dhe për krijimin e partneriteteve me universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë. **[3.1]** Neni 16 parashikon krijimin e një Këshilli autonom të Etikës, për të siguruar procesin e duhur dhe trajtimin e drejtë të stafit dhe studentëve nga ana e Kolegjit Universitar. Neni 33 i Statutit dhe Neni 70 i Rregullores së Përgjithshme parashikojnë të drejtat dhe detyrimet e studentëve. **[3.1; 3.3]** Neni 79 i Rregullores së Përgjithshme mbron lirinë akademike të stafit të punësuar, duke lejuar: pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore dhe kërkimore dhe në botime; zbatimin e metodave dhe përmbajtjes së procesit mësimor sipas kurrikulës; dhe të drejtat e tjera të parashikuara në lidhje me punësimin në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007: “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. **[3.6]** Stafi i kontaktuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u shprehën se ata ushtronin autonomi akademike dhe intelektuale. **[M1; M7]** Kolegji Universitar përmbush kërkesat e nevojshme për t’u njohur si Shkollë e Lartë sipas ligjit shqiptar, duke qenë se ajo ofron programe të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë të studimit në nivelet e duhura dhe ofron numrin e duhur të krediteve dhe kryen kërkim shkencor, nëpërmjet dy fakulteteve, pesë departamenteve dhe një qendre kërkimore. **[RVV fq.14]** Numri i stafit mësimdhënës dhe gradat dhe titujt e tyre i tejkalon në mënyrë të konsiderueshme kërkesat minimale ligjore për një Shkollë të Lartë. **[RVV fq. 14; GID 5.2-3] [Kapitulli III Standardi II.1]**

1.8 Siç përcaktohet në pikën 1.2, Kolegji Universitar operon një strukturë të mjaftueshme dhe të qartë të organeve të qeverisjes dhe politikëbërjes, që e lehtësojnë në mënyrë të përshtatshme debatin dhe vendimmarrjen. **[4.1-5; RVV fq.15] [Kapitulli III Standard II.3]**

1.9 Statuti i Kolegjit Universitar dhe Plani Strategjik i saj e përcaktojnë qartë misionin për ofrimin e arsimit dhe kualifikimit në fushat e nevojshme për tregun e punës në Shqipëri dhe janë në përputhje me Planin Kombëtar të Zhvillimit. Në veçanti, Kolegji Universitar ofron programe të nivelit Bachelor dhe programe të ciklit të dytë të konceptuara për të plotësuar nevojat e ekonomisë në financë, menaxhim dhe turizëm, dhe në informatikë dhe teknika për laboratorët mjekësorë. **[3.1; 3.2; 3.6; M1; M6]** Kolegji Universitar ka një Zyrë të Këshillimit të Karrierës dhe monitoron dhe mban të dhëna për vendet ku punësohen studentët e vet. **[12.2; 12.5; 12.6] [Kapitulli III Standardi III.1]**

1.10 Kolegji Universitar ka nënshkruar marrëveshje me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare në mënyrë që të përparojë misionin dhe prioritetet e tij, për të ofruar arsimim dhe trajnim në fushat kryesore ku ka mungesë aftësish në ekonomi, dhe gjithashtu për të përmirësuar kapacitetin e tij, që të angazhohet në projekte të përbashkëta kërkimore, konferenca dhe shkëmbime të stafit dhe studentëve. Një marrëveshje kryesore (2011) është nënshkruar me Universitetin e Pireut, për shkëmbime stafi dhe studentësh dhe për të bashkëpunuar në një sërë projektsh. **[Dokumente shtesë]** Kjo ka sjellë vizita të rregullta të stafit akademik nga Pireu, por asnjë student apo anëtar stafi nuk ka kryer vizita në Greqi. **[M7]** Në kohën e vizitës së vlerësimit, ishin parashikuar marrëveshje të tjera me Universitetin Aristotelit të Selanikut, Universitetin Helenik Ndërkombëtar, në Selanik, Universitetin e Kretës dhe Universitetin e Qipros. **[RVV fq.16.] [Kapitulli III Standardi III.2]**

1.11 Një pjesë e rëndësishme e arsimit dhe trajnimit të ofruar nga Kolegji Universitar përfshin praktika profesionale dhe stazhe në ambientet përkatëse profesionale, si kompanitë private, bankat dhe organizatat financiare, qendrat shëndetësore dhe spitalet. **[3.3; 3.5; 3.12; 11.3]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me përfaqësuesit e organizatave që u mundësojnë studentëve të përmbushin kërkesat praktike të programeve të veçanta studimore dhe me të cilat Kolegji Universitar ka marrëveshje. **[M6]** Këta përfaqësues pohuan se përfitimin i këtyre marrëveshjeve është reciprok dhe se ata ofronin trajnim të efektshëm në punë. **[M6] [Kapitulli III Standardi III.3]**

1.12 Megjithëse Kolegji Universitar ka nënshkruar një sërë marrëveshesh, për të lehtësuar mobilitetin e akademikëve dhe studentëve, si dhe për të vizituar institucionet e arsimit të lartë në vende të tjera, deri më sot nuk ka pasur mobilitet ndërkombëtar të stafit dhe studentëve. Asnjë anëtar i stafit apo student me të cilët komunikoi Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, nuk ishin në gjendje të jepnin shembuj të vizitave të tilla, arsyet kishin të bënin me mungesën e fondeve institucionale për këto mundësi. **[M2; M5]** Ky problem ishte përmendur në RVV dhe e çon vëmendjen te pjesëmarrja e kufizuar në projektet ndërkombëtare. **[RVV]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi faktin se Kolegji Universitar “Logos” ka vendosur për studentët e tij tarifa relativisht të ulëta dhe se ka subvencione nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, që është përfshirë në kuadër të marrëveshjes së financimit për Kolegjin Universitar; Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjithashtu pohoi faktin se Kolegji Universitar ka ofruar bursa për studentët në nevojë ekonomike. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi si një **dobësi** mungesën e mbështetjes financiare për veprimtaritë kërkimore, si udhëtimet dhe pjesëmarrjen në konferenca dhe zbatimi shumë i kufizuar i mundësive të mobilitetit për stafin dhe studentët, dhe **rekomandon** që Kolegji Universitar “Logos” të krijojë fonde nga të cilat stafi dhe studentët të mund të mbështeten, për të përfituar nga mundësitë e mobilitetit të siguruara, nëpërmjet marrëveshjeve të tyre të bashkëpunimit dhe aktivitetet e konferencës, brenda gjashtë muajve pas marrjes në dorëzim të raportit përfundimtar. Në lidhje me mobilitetin e studentëve Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si një **dobësi** mungesën e angazhimit në mundësitë e ofruara nga skema Erasmus për mobilitetin e studentëve dhe **rekomandon** që Kolegji Universitar “Logos” të mbështesë aplikimet, për të përfituar nga mundësitë e ofruara nga përfshirja e Shqipërisë në skemën Erasmus për mobiliteti i studentëve, brenda 12 muajve nga marrja e raportit përfundimtar. Këto çështje janë ngritur edhe në pikat 4.24, 4.25 dhe 4.27 **[Kapitulli III Standardi III.4]**

1.13 Kolegji Universitar “Logos” është një institucion relativisht i ri i arsimit të lartë, duke qenë se u licencua për herë të parë që të ofrojë programe të ciklit të parë në korrik të vitit 2009. Megjithatë, Kolegji Universitar ka një mision të përcaktuar qartë në përmbushje të nevojave të arsimit të lartë dhe kërkesave për aftësi profesionale të ekonomisë shqiptare në fushat e ekonomisë, menaxhimit dhe financës, në informatikë të aplikuar dhe në trajnimin e teknikëve të laboratorëve mjekësorë. Kolegji Universitar “Logos” ka zhvilluar strukturat e përshtatshme qeverisëse dhe kapacitetet e menaxhimit, për të mbështetur një kapacitetet prej rreth 400 studentëve të ciklit të parë dhe të dytë, dhe ka plane për të krijuar një fakultet të tretë në Shkencat Humane dhe Gjuhësi. Kolegji Universitar gjithashtu ka vendosur një synim afatgjatë, për të ndërtuar një kampus të ri jashtë Tiranës. Ndërsa Kolegji Universitar “Logos” ka ambicie për të zhvilluar lidhjet e tij ndërkombëtare aktualisht ka vetëm një lidhje efektive (me Universitetin e Pireut) dhe mobiliteti i stafit dhe studentëve është aktualisht një fushë që përbën dobësi.

## Gjetjet

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e mbështetjes financiare për veprimtaritë kërkimore, si udhëtimi dhe pjesëmarrja në konferenca dhe ofrimi shumë i kufizuar i mundësive të mobilitetit për stafin dhe studentët (pikat 1.12, 4.24, 4.25 dhe 4.27; **Kapitulli III Standardi III.4, Kapitulli II Standardi I.1, Kapitulli II Standardet I.2, Kapitulli II Standard I.6**)
- mungesa e angazhimit në mundësitë e ofruara nga skema Erasmus për mobilitetin e studentëve (pikat 1.12, 4.24 dhe 4.25, **Kapitulli III Standardet III.4, Kapitulli II Standardi I.3**)

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- që Kolegji Universitar “Logos” të krijojë fonde me të cilat mund të mbështeten stafi dhe studentët, për të përfituar nga mundësitë e mobilitetit, që mund të ofronin marrëveshjet e tyre të bashkëpunimit dhe aktivitetet e konferencës, brenda gjashtë muajve nga marrja e raportit përfundimtar (pikat 1.12, 4.24, 4.25 dhe 4.27; **Kapitulli III Standardet III.4, Kapitulli II Standardet I.1, Kapitulli II Standardet I.2, Kapitulli II Standardet I.6**)
- që Kolegji Universitar “Logos” të mbështesë aplikimet për të përfituar nga mundësitë e ofruara nga përfshirja e Shqipërisë në skemën e Erasmus, për sa in përket mobilitetit të studentëve, brenda 12 muajve nga marrja e raportit përfundimtar (pikat 1.12, 4.24 dhe 4.25, **Kapitulli III Standardi III.4, Kapitulli II Standardi I.3**)

### Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim të ndërmarrë.

## Gjykimi

**Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin janë përmbushur kryesisht.**



## Fusha e vlerësimit 2: Burimet

2.1 Kolegji Universitar "Logos" ndjek një procedure të hapur, publike dhe konkurruese për rekrutimin e stafit. **[3.6]** Neni 21 i Rregullores së Përgjithshme nuk lejon diskriminim në bazë të bindjeve politike, orientimit fetar, gjuhësor, racor, filozofik, dhe bindjeve fetare. **[3.3]** Procedurat e ndjekura janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë nr. 9715 (2007). **[RVV]** Kërkesat për një vend pune me kohe të plotë ose të pjesshme i propozohen Rektorit, në përgjithësi nëpërmjet dekanit të një fakulteti. Kërkesa përfshin një përshkrim të shkurtër të pozicionit dhe specifikimet e dëshiruara për personin. **[3.6; 6.14]** Procesi menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore **[3.3]** Vendet e lira shpallen në faqen e internetit të Kolegjit Universitar dhe në disa raste me anë të mediave të tjera. Neni 79 i Rregullores së Përgjithshme specifikon kualifikimet minimale për emërimet akademike. **[3.3]** Rektori emëron anëtarët e komisionit të posaçëm të emërimeve, që përzgjedh kandidatët për t'u intervistuar, kryen intervistat dhe emëron kandidatin e preferuar tek Rektori, i cili e merr vendimin përfundimtar. **[3.6. RVV] [Kapitulli III Standardi IV.1]**

2.2 Kolegji Universitar "Logos" i është përkushtuar instruktimit të duhur të stafit të ri dhe integritetit të tyre jo vetëm në punën e institucionit, por edhe në jetën e vet shoqërore. Kolegji Universitar rregullon ngarkesën mësimore të punonjësve, për t'i lejuar që të ndërmarrin trajnime të miratuara ose të kryejnë kualifikime të mëtejshme, si p.sh. studimet doktorale. **[M2]** Kjo është pohuar në mbledhjet me stafin akademik dhe atë ndihmës. **[M7;M8] [Kapitulli III Standard IV.2]**

2.3 Punonjësit dhe stafi akademik i Kolegjit Universitar vlerësohen çdo vit. **[RVV]** Mësimdhënia e zhvilluar nga stafi akademik vlerësohet pjesërisht, nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar nga studentët. **[8.7]** Kolegji Universitar ruan të dhëna për zhvillimit akademik të stafit mësimdhënës, kualifikimet e tyre, pjesëmarrjen në konferenca shkencore. **[8.7]** Kolegji Universitar mban regjistra për zhvillimin akademik të stafit mësimdhënës, kualifikimet e tyre, pjesëmarrjen në konferenca shkencore, brenda dhe jashtë vendit, dhe trajnimin profesional të ndërmarrë në institucione të tjera. **[3.6] [Kapitulli III Standardi IV.3]**

2.4 Kolegji Universitar synon të mbështesë shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme të stafit dhe të ofrojë udhëzime shëndetësore me shkrim, si edhe një sërë aktivitetesh sociale. **[13.5; RVV] [Kapitulli III Standardi IV.4]**

2.5 Kolegji Universitar operon një njësi të Burimeve Njerëzore brenda Njesisë së Menaxhimit, dhe të gjitha kontratat e stafit janë në pajtim me legjislacionin aktual shqiptar për punësimin në arsimin e lartë. **[Ligji nr. 9741, datë 21.05.2007; 3]** Punonjësit dhe stafi akademik i Kolegjit Universitar vlerësohen çdo vit dhe regjistrat për secilin anëtar të stafit mbahen në Zyrën e Burimeve Njerëzore. **[RVV; M2; M7] [Kapitulli III Standard II.2]**

2.6 Kolegji Universitar "Logos" vepron në kuadrin financiar të Fondacionit nga i cili merr subvencione të rëndësishme vjetore si për financimin, ashtu edhe mirëmbajtjen e ndërtesës dhe pajisjeve. **[1.1-4; 3.6; RVV]** Zyra e Financës brenda Kolegjit Universitar përpilon pasqyrat vjetore financiare, të cilat shqyrtohen nga Bordi i Administrimit dhe i dorëzohen Fondacionit. **[3.10; 13.3; RVV]** Zyra e Financës përgatit dokumentacionin që tregon se Kolegji Universitar respekton të gjitha kërkesat ligjore, siç janë pagesat e taksave dhe sigurimet shoqërore për stafin dhe deklarimin e të gjitha të ardhurave dhe kostove. **[13.1-4; RVV]** Pasqyrat vjetore të Kolegjit Universitar janë subjekt i auditimit të jashtëm profesional të pavarur. **[13.2; RVV] [Kapitulli III Standardi VI.1, Kapitulli III Standardi VI.2, Kapitulli III Standardi VI.3]**

2.7 Faqja e internetit e Kolegjit Universitar disponon të gjitha informacionet e kërkuara për numrin e studentëve, programet e ofruara, strukturën organizative dhe statutet dhe rregulloret që zbatohen për qeverisjen e institucionit. **[www.shlplogos.edu.al]** Grupi i

Vlerësimit të Jashtëm takoi stafin përgjegjës për ofrimin dhe menaxhimin e sistemeve elektronike të informacionit të Kolegjit Universitar. **[M2; M8]** Është pohuar se shumica e informacionit për studentët mbahet në baza të ndryshme të të dhënave dhe gjithashtu në dosje fizike, dhe se kohët e fundit Kolegji Universitar ka investuar në një sistem të dhënash më të plotë të studentëve dhe aktualisht po e popullon këtë sistem të dhënash me informacione. **[M8]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon zhvillimin e vazhdueshëm të sistemit elektronik të të dhënave të studentëve dhe aksesin për informacion në internet (shih gjithashtu pikën 2.11) **[Kapitulli III Standardi VII.1 dhe V. 2] [Kapitulli III Standardi VII.1]**

2.8 Programet akademike të ofruara nga Kolegji Universitar kërkojnë sigurimin e pajisjeve dhe programeve kompjuterike të përshtatshme, veçanërisht programet në Informatikë të Aplikuar dhe në Financë dhe Biznes. Kolegji Universitar ofron katër laboratorë kompjuterikë, dhe si kompjuterat, ashtu edhe serverët kryesorë operojnë programet e duhura dhe programet grafike dy dhe tre-dimensionale. **[11.9; SER; M2, M5, M8]** Procesi i buxhetimit vjetor i lejon departamenteve të propozojë një ofertë për pajisje dhe programe të reja, dhe blerjet mund të bëhen brenda një viti, nëse është e nevojshme, duke ia paraqitur kërkesat Fondacionit. **[M2; M8]** Studentët dhe stafi janë të kënaqur me ofrimin e teknologjisë së informacionit. **[M3; M4; M7]** Kolegji Universitar nuk ofron programe për mësimin në distancë. **[Kapitulli III Standard VII.2]**

2.9 Ambientet në kuadër të së cilës vepron Kolegji Universitar ofrohen falas nga Fondacioni dhe nga Kisha Ortodokse Autoqefale, e cila gjithashtu siguron mirëmbajtjen e tyre. **[1.1-4; 3.6; M1]** Kolegji Universitar ka zhvilluar plane për të ndërtuar një kampus të ri modern në tetë hektarë tokë jashtë Tiranës, por që varen nga zgjerimi i programeve dhe numrit të studentëve. **[M1; RVV]** Kolegji Universitar ka rregullime dhe ambiente të përshtatshme, për të vendosur të gjithë fondin e tij akademik brenda bibliotekës së tij, dhe dokumentacionin e tij administrativ dhe arkivat brenda zyrës së regjistrimit, përfshirë dosjet administrative dhe bazat e të dhënave. **[RVV; M2]** Kolegji Universitar ka politika dhe plane të përshtatshme, të mbështetura nga një infrastrukturë e mjaftueshme administrative, për të menaxhuar, mbajtur dhe zhvilluar asetet e veta. **[Kapitulli III Standard VII.3, Kapitulli III Standard VII.4, Kapitulli III Standard VII.5, Kapitulli III Standard VII.6]**

2.10 Kolegji Universitar “Logos” zë katër kate të një ndërtese të mirëmbajtur në Tiranë. Sallat e leksioneve, klasat, laboratorët, biblioteka dhe hapësira e studimit dhe zyrat duken të përshtatshme për qëllimin e përcaktuar. **[Vizita në terren]** Kolegji Universitar dëshmon se janë përmbushur ose tejkaluar që të gjitha normat e kërkuara në aspektin e hapësirës, ngrohjes, ndriçimit, mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit nga zjarri, furnizimit me energji në raste emergjente, dhe kushtet e higjienës dhe ato sanitare. **[RVV; 14.1-4] [Kapitulli III Standardi V.1]**

2.11 Shkolla ruan gjithë dokumentacionin për veprimtarinë e tij akademike (informacione për programin dhe kurset, regjistrat e stafit, regjistrimet e studentëve përfshirë regjistrimin, matrikullimin, përparimin e studentëve dhe vendet ku punësohen të diplomuarit, dhe kopjet e notave të marra dhe diplomave dhe suplementet e diplomave lëshuar studentëve). **[RVV; M8]** Kolegji Universitar po zhvillon një sistem elektronik të të dhënave dhe aksesin në internet; ky konstatim mbështet pohimin në pikën 2.7 **[M8] [Kapitulli III Standardi V.2]**

2.12 Kolegji Universitar “Logos” ka aktualisht dhe zbaton në mënyrë të efektshme politikat për menaxhimin e burimeve të veta njerëzore dhe fizike. Politikat dhe procedurat e rekrutimit janë të hapura dhe transparente. Ka marrëveshje për instruktimin e stafit të ri dhe për vlerësimin e tyre, zhvillimin dhe trajnimin e stafit ekzistues. Menaxhimi financiar i Kolegjit Universitar është i kujdesshëm dhe përputhet me kërkesat ligjore. Kolegji Universitar angazhohet në planifikim vjetor dhe afatgjatë dhe ka mekanizma për mirëmbajtjen dhe përditësimin e pajisjeve dhe burimeve të bibliotekës të nevojshme, për realizimin e programeve të tij. Ndërtesat dhe hapësira e përdorur nga Kolegji Universitar i përmbushin

ose i tejkalojnë normat ligjore, janë të përshtatshme për qëllimin e përcaktuar dhe të mirëmbajtura. Kolegji Universitar ruan në mënyrë të sigurt dhe në një formë të aksesueshme të gjithë dokumentacionin dhe arkivat e nevojshme për të mbështetur mësimnxënien, mësimdhënien dhe kërkimin dhe po përmirëson sistemet e veta në internet.

## **Gjetjet**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë karakteristike të praktikës së mirë.

### **Dobësi**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

### **Pohim i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e mëposhtëm të ndërmarrë:

- zhvillimi i vazhdueshëm i sistemit elektronik të të dhënave të studentëve dhe aksesit në informacionin në internet (pikat 2.7 dhe 2.11; **Kapitulli III Standard VII.1, Kapitulli III Standard V.2**)

## **Gjykimi**

**Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.**

## Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Kolegji Universitar “Logos” përcakton se misioni i vet është të “zhvillojë, transmetojë dhe zgjerojë njohuritë në procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit”. **[3.1 neni 2, 3.3 neni 4]** Ka dy njësi kryesore, Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Shkencave të Aplikuara. Fakulteti i Ekonomisë përfshin Departamentet e Menaxhim Biznesit, Financës dhe Kontabilitetit dhe Menaxhim Turizmi. Shkencat e Aplikuara përfshijnë Departamentin e Informatikës së Aplikuara, dhe Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë dhe një Qendër Kërkimi Shkencor dhe Zhvillimi. **[3.1 neni 3]** Në përputhje me këtë mision, fakultetet midis tyre ofrojnë programe në dy ciklet e para të Bolonjës. **[3.1 neni 4] [Kapitulli I Standardi I.1]**

3.2 Kolegji Universitar “Logos” ofron informacion për publikun në lidhje me programet e ofruara. Kriteret e regjistrimit të studentëve parashtrihen në Strategjinë dhe Rregulloret. **[3.2 fq.9; 3.3 neni 39,40, 42]** Informacione të tilla ofrohen në faqen e internetit, e cila përshkruan kriteret e pranimit dhe programet e ofruara në fushat përkatëse të lëndëve. **[<http://www.shlplogos.edu.al>]** Kolegji Universitar zhvillon një fushatë informimi në shkallë të gjerë për të promovuar programet e studimit që ofron. Fushata fillon në shkurt deri në mars, dhe në 2016, janë organizuar takime në shkollat e mesme në Berat, Kuçovë, Urë Vajguore dhe Lushnjë, si dhe në Tiranë. **[M3 q1-4; M4 q1-4; M8]** Kolegji Universitar përgatit broshura informuese, fletëpalosje dhe udhëzime për studentët. **[Dokument i plotësuar: Udhëzuesi i studentëve]**

3.3 Programet e studimeve janë të konceptuara për të nxjerr të diplomuar cilësor, që plotësojnë kërkesat e tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve, **[M2; M4; M6; M7]** duke qenë në përputhje edhe me misionin e vet. **[3.1 neni 4]** Ka rregullore për çdo program studimi. **[3.3; 3.4; 3.5]** Kolegji Universitar përcakton rregulla të qarta për vlerësimin; vlerësimi në nivel programi i nënshtrohet shqyrtimit dhe vlerësimit nga stafi akademik në departamentet, dhe miratohet nga Senati Akademik. **[3.3 ch 6 neni 52, pika 7 neni 54,55,56,57,58, 59] [Kapitulli I Standardi I.1].**

3.4 Kolegji Universitar “Logos” ofron studime në programet e ciklit të parë dhe të dytë në të dy fakultetet; programet e Masterit Profesional (cikli i dytë) janë caktuar të zhvillohen pasdite. **[M4]** Institucioni nuk ofron studime me kohë të pjesshme pas ndryshimeve legjislative nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) në vitin 2014, që nuk parashikon programe me kohë të pjesshme. **[Kapitulli I Standardi I.2]**

3.5 Kolegji Universitar “Logos” synon t’u ofrojë studentëve njohuri bazë në përputhje me parimet shkencore dhe me “aftësitë dhe kompetencat e vërteta”. **[Dokumenti 3.2]** Kolegji Universitar “Logos” ka punuar për përmirësimin e infrastrukturës në auditorë, përfshirë laboratorët për Informatikë të Aplikuara dhe Programet për Teknikë të Lartë të Laboratorëve Mjekësorë. Po ashtu ka kërkuar të rekrutojë staf akademik me ekspertizë në fushat përkatëse të shkencave mjekësore, shkencave ekonomike dhe informatikës. **[3.1; M2; M3; M4; M7]** Përvoja e stafit akademik të fituar, nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca apo projekte, gjithashtu mbështet mësimdhënien e tyre. **[M7 q.1; 1,1-4; 3.6; 11.9]** Në mënyrë kolektive, këto procese sigurojnë që Kolegji Universitar të ofrojë programe në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional dhe në përputhje me tendencat vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. **[Kapitulli I Standardi I.3]**

3.6 Kolegji Universitar “Logos” ofron programe studimi në përputhje me tendencat e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar. Informacion rreth tendencave të tilla ofrohet nga stafi akademik me kohë të pjesshme, të cilët janë gjithashtu profesionistë, nëpërmjet studimit të tregut, përvojave të stazhit të studentëve në organizata të ndryshme dhe nga pjesëmarrja e stafit në konferenca dhe studime të mëtejshme në Shqipëri dhe jashtë saj. **[Dokumenti 6.a i shtuar; dokument shtesë 6.b; M2; M4; M6; M7; M4]** Studimi i tregut zakonisht kryhet nga departamenti përkatës, për të identifikuar nevojat e tregut dhe për të informuar kurrikulën,

por nuk ka një proces formal për punëdhënësit partnerë ose për të diplomuarit që të informojnë zhvillimin e programeve. Ky konstatim mbështetet rekomandimet lidhur me përmirësimin e cilësisë dhe zhvillimin e programeve në pikat 4.18, 4.19 dhe 4.20. **[M5; M7; 3.7]** Plani strategjik thekson qëllimin e Kolegjit Universitar “Logos” që të vazhdojë të angazhohet me partnerët rajonalë, grupet e interesit dhe bizneset dhe të vazhdojë të zhvillojë partneritete kuptimplota në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si ato me Universitetin e Pireut dhe Universitetin Ndërkombëtar të Greqisë. **[M7; 4.4; 5.4c]** **[Kapitulli I Standardi I.4]**

3.7 Kolegji Universitar “Logos” i përshtat programet e tij me infrastrukturën e vet dhe burimet e stafit akademik dhe personelit mbështetës. **[4.4; 5.4c; 14.4; 13.5]** Aktualisht secili departament ka të paktën shtatë punonjës akademikë në kohë të plotë, duke qenë në përputhje me kërkesat e MAS dhe APAAL-it. **[M1; M; 2; GID]** Infrastruktura është e përshtatshme dhe i plotëson kërkesat për mësimdhënie teorike dhe praktike. Laboratorët janë të pajisur për trajnim praktik. **[M3; M4, M6; M7; 14.4]** Strategjia e zhvillimit për periudhën 2016-2021 përfshin një plan për rritjen e numrit të studentëve, nëpërmjet krijimit të një fakulteti të tretë dhe ndërtimin e një kampusi, që do t'i plotësojë të gjitha nevojat mësimore të studentëve si dhe sigurimin e akomodimit të studentëve. **[M1; M8; vizita në terren; 3.2]** **[Kapitulli I Standardi I.5]**

3.8 Kolegji Universitar “Logos” zbaton një program orientimi për studentët e rinj që mbulon kurrikulën e tyre dhe modulet përbërëse, natyrën e vlerësimeve të tyre, penalitete për kopjimin në provime, bibliotekën dhe burimet e të mësuarit, dhe ku të drejtohen për këshillim dhe ndihmë. **[M2; M3; M4]** Në disa raste studentët e vitit të dytë mirëpresin studentët e vitit të parë. **[M3]** Stafi akademik prezanton përmbajtjen e syllabusit në orën e parë mësimore të çdo viti akademik. **[M3]** Një sistem online e plotëson këtë informacion, duke siguruar që secili student të ketë orarin e tij, notat, njoftimet rreth veprimtarive dhe informacione të tjera rreth programit. Çdo modul ka objektivat e veta. Rregullorja e Përgjithshme dhe Strategjia e Zhvillimit 2012-2016 përcakton kriteret e pranimit të studentëve. **[3.3 neni 39; 3.2 fq.9]** **[Kapitulli I Standardi I.6]**

3.9 Programet e studimeve të ciklit të parë i pajisin studentët me njohuri themelore, të cilët përvetësojnë metoda dhe parime të përgjithshme shkencore dhe përfshijnë mundësi për përvojë praktike, përfshirë praktikën profesionale me partnerët e jashtëm. **[M4, M6]** Një shembull është ai i teknikëve të lartë për laboratorët mjekësorë në të cilën studentët fitojnë përvojë praktike, që u mundëson atyre të orientohen me sukses drejt punësimit. **[M4; M6; 5.2; 5.3a; 5.3b]** Teoria bashkohet me praktikën e vitit të dytë të studimit, duke vazhduar me stazhin praktik tremujore. **[M4]** Programet e studimeve lejojnë një tranzicion progresiv nga studimi i ciklit të parë në ciklin e dytë; të diplomuarit që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë, kanë përparuar me sukses në ciklin e dytë. **[M4]** Programet e studimeve të ciklit të parë organizohen në 15 javë, me një ndarje të paracaktuar ndërmjet mësimit teorik dhe praktik brenda ngarkesës mësimore javore. Ndërsa kurrikula synon të balancojë mësimin teorik dhe praktik, disa degë, siç është programi i teknikut mjekësor, i kushtojnë më shumë vëmendje praktikës, **[M7]** në përgjigje të kërkesave të studentëve. **[M3; M4; 5-2-1, 5-2-2]** Studentët që përfundojnë programin e ciklit të parë janë të përgatitur për të hyrë siç duhet në tregun e punës. Lidhjet e ngushta të Kolegjit Universitar me punëdhënësit ofrojnë një shumëllojshmëri të gjerë të mundësive për përvojë praktike dhe stazhe, dhe punëdhënësit partnerë dhe alumni kanë dhënë shembuj të ofertave për punë që u bëhen studentëve në bazë të stazhit të tyre. **[M6; M4]** Studentët janë të vetëdijshëm për mundësinë e transferimit midis programeve të studimit dhe procedura e transferimit është përcaktuar në Rregulloren e Përgjithshme. **[3.3 neni 37, 38]** **[Kapitulli I Standard I.7]**

3.10 Kolegji Universitar “Logos” ofron një program tutorimi për studentët. Pedagogët kujdestarë ofrojnë mbështetje shtesë, të tilla si ndihmë për studentët që kërkojnë të përmirësojnë performancën e tyre dhe mund të përfitojnë nga orë shtesë. **[M3; M7; 3.3 neni**

**41]** Pedagogët përkatës gjithmonë shqyrtojnë përgjigjet e provimit të studentëve për t'iu dhënë studentëve feedback në lidhje me performancën e tyre dhe pedagogu kujdestar mund të mbajë lidhje me pedagogun në emër të studentit. **[M3]** ZKK siguron ndihmë dhe këshillim si dhe shpërndan informacion të vlefshëm për mundësitë e punësimit. **[M8; 12.5; 12.6]** Mund të ofrohen qasje të ndryshme për mësimnxënien në reflektim të formimit të studentëve. **[M7]** Për shembull, për Teknikët e Lartë për Laboratorët Mjekësorë, mund të ofrohen punë praktike shtesë gjatë periudhës së pushimeve, për ta bërë lëndën më tërheqës për studentët. **[M7]** Kolegji Universitar “Logos” synon të rekrutojë staf akademik me përvojë profesionale, për shembull në spitale dhe klinika të njohura. **[M2; M7]** Punësimi i stafit me kohë të pjesshme, që mund të ndërthur mësimdhënien e tyre me rolin profesional të praktikës konsiderohet si një pike e fortë, pasi ata sjellin shembuj të jetës reale dhe studime rastesh për tema, që nga ana tjetër, janë të mbuluara në teori. **[M2; M7; M8]** Janë bërë përpjekje për të përmbushur kërkesat e MAS dhe APAAL-t, për të pasur së paku shtatë staf akademik për çdo departament. **[M1; M7]** Për vitin 2015-2016 u angazhuan 32 pedagogë me kohë të plotë dhe 29 me kohë të pjesshme. Për vitin akademik 2016-2017, u angazhuan 41 staf akademik me kohë të plotë, ndërsa 14 me kohë të pjesshme. **[6.1, 4.4] [Kapitulli I Standard I.8]**

3.11 Stafi akademik që jep mësim në programet e Masterit Profesional të ciklit të dytë, merr pjesë në projekte dhe konferenca ndërkombëtare dhe ata e shfrytëzojnë këtë përvojë për të përmirësuar modulet e tyre. **[M7]** Programet Master Profesional zhvillohen gjatë tre semestrave. Ata janë në përputhje me misionin e Kolegjit Universitar dhe strategjinë e zhvillimit dhe me kërkesat e tregut, **[3.2; 3.3; Dokument shtesë 6.a; dokument shtesë 6.b]** të cilat synojnë të ofrojnë kualifikim të lartë dhe trajnim teorik dhe praktik në punë, **[3.2; 3.3]** duke u përqendruar veçanërisht në praktikën profesionale. ZKK siguron lidhje me komunitetin, duke përfshirë spitalet dhe klinikat në Tiranë, institucionet bankare dhe kompanitë kontabël. Praktika profesionale lehtësohet, nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkruara midis partnerëve dhe Kolegjit Universitar “Logos”, ndërsa studentët fitojnë njohuri të konsiderueshme dhe përvojë nga praktikat e tyre. **[M4] [Kapitulli I Standardi I.9]**

3.12 ZKK mban të dhënat e punësimit të studentëve, edhe pse mund të jetë e vështirë për ta bërë, në kushtet kur të diplomuarit ndryshojnë detajet e kontaktit të tyre. **[Dokument shtesë 7.a; dokument shtesë 7.b]** Zyra ka krijuar një shoqatë alumni, për të mbajtur kontakte, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin midis të rinjve që janë ende të pasigurt rreth mundësive të tyre të punësimit, pas përfundimit të studimeve të tyre. **[M6]** Kolegji Universitar “Logos” ka bërë përpjekje për të përmbushur kërkesat e MAS dhe APAAL-it lidhur me numrin e stafit akademik të kërkuar (shih gjithashtu pikën 3.10). **[M1; M7; 6.1; 4.4] [Kapitulli I Standardi I.9]**

3.13 Programet e studimit ofrohen në përputhje me rregullat dhe rregulloret e përcaktuara nga MAS, Rregulloret e Përgjithshme të Kolegjit Universitar dhe Procesit të Bolonjës për të dy ciklet, përkatësisht Bachelor dhe Master. Detajet e kurrikulës përmbajnë informacion të vlefshëm për temat e studimit dhe literaturën e rekomanduar dhe vlerën e krediteve janë në përputhje me Sistemin Europian për Transferimin dhe Akumulimin e Krediteve (ECTS). Kolegji Universitar lëshon Supplement Diplome sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloret e Përgjithshme për të dy ciklet e studimit. **[3.1; 3.3 ch 10, neni 65, neni 67 dhe 68]** Programet e studimeve janë të konceptuara, për të lehtësuar mobilitetin e studentëve siç janë të parashikuara në Rregulloret e Përgjithshme. **[3.3 Kap. 7]** Studimi në gjuhën greke dhe në gjuhën angleze ofrohet për dy vjet studim në ciklin e parë, dhe secili prej tyre ka dy kredite për semestër. **[M4; ] [Kapitulli I Standardi I.10]**

3.14 Programet e studimit në ciklin e parë dhe të dytë përfshijnë orë mësimore teorike dhe praktike. Gjatë vitit të parë, studentët përfitojnë njohuri të përgjithshme përpara se të ndjekin në mënyrë profesionale programe më të zbatuara. Në programin e teknikëve të lartë për laboratorët mjekësorë, ka një ndarje të barabartë midis teorisë dhe praktikës në vitin e

parë. Studentët në programet, si kontabiliteti angazhohen me praktikën profesionale në vitin e fundit; këta studentë gjithashtu shpenzojnë orë studimi në programin e posaçëm kompjuterik (shih gjithashtu pikën 4.11). **[dokument shtesë 11.d; M4, M6, M7]** Në fund të studimeve të tyre, studentët përgatisin tezën e diplomës në përputhje me Rregulloret e Përgjithshme të Kolegjit Universitar dhe me rregullat e veçanta të fakultetit. **[3.3; 3.4]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u vu në dijeni të një shembulli të një studenti që kishte dy udhëheqës për tezën e tij, një nga Kolegji Universitar “Logos” dhe tjetri nga Klinika Ortodokse, ku ai kishte bërë praktikën e tij. **[M6]** Kolegji Universitar “Logos” gjithashtu mbështet veprimtaritë e studentëve si një grup futbollit dhe një grup muzikor. **[M3; M4; M7] [Kapitulli I Standardi I.11]**

3.15 Programet e studimit në të dy ciklet (Bachelor dhe Master Profesional) kanë karakter teknik. Teknikët e Lartë Laboratorësh Mjekësorë dhe Programet e Aplikuara të Informatikës janë posaçërisht të përshtatura me nevojat e tregut të punës; **[Dokument shtesë 6.a; dokument shtesë 6.b]** ato përmbajnë si njohuri teorike, ashtu edhe praktike. Ky raport ndryshon gjatë ciklit të dytë kur shumica e klasave janë praktike dhe studentët zhvillojnë praktikën profesionale për tre muaj. **[M3; M4; M7]** Shembuj të zhvillimeve përfshijnë histologjinë, në përgjigje të rritjes së normave të kancerit në Shqipëri; vlerësimin e të dhënave statistikore për turizmin; dhe një projekt turistik në bashkëpunim me organizata të tjera që përqendrohen në zonën e Durrësit. Programet e studimeve në Fakultetin e Ekonomisë përmban njohuri për sipërmarrjen. Disa module të specializuara trajtojnë njohuritë teorike, siç janë analiza e rrezikut ose sistemi fiskal, dhe mbi këto njohuri, studentët vijojnë me zhvillimin e formimit të tyre gjatë praktikave. **[M3; M4; M6] [Kapitulli I Standardi I.12]**

3.16 Kolegji Universitar “Logos” përdor mjete të përshtatshme për promovimin e programeve studimore, si nëpërmjet faqes së internetit, vizitave në shkollat e mesme, fletëpalosjeve dhe udhëzuesit të studentëve, si dhe përdorimin e mediave të tjera. Programet e studimeve ofrohen në dy cikle, Bachelor dhe Master Profesional; ato janë në përputhje me ciklet e studimit të procesit të Bolonjës dhe pasqyrojnë kërkesat kombëtare të tregut të punës. Programet gjithashtu harmonizohen me Statutin dhe strategjinë e zhvillimit të Kolegjit. Ai zhvillon kurrikulën nëpërmjet përvojës profesionale të stafit, përfshirë edhe stafit me kohë të pjesshme, mbështetur nga pjesëmarrja e stafit akademik në konferenca dhe projekte, veçanërisht në ciklin e dytë, ku praktika profesionale është e rëndësishme. Kolegji Universitar “Logos” ka përmirësuar infrastrukturën e mësimdhënies, duke përfshirë laboratorët për informatikë dhe për studimet për teknikë mjekësorë, dhe ata përpiqen të rekrutojnë staf akademik me ekspertizë në fushat përkatëse të studimeve mjekësore, shkencave ekonomike dhe informatikës. Programet e ofruara në Kolegji Universitar “Logos” harmonizohen në përputhje me infrastrukturën dhe numrin e stafit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Programet e ciklit të parë planifikojnë përfitimin e njohurive të përgjithshme, teorike dhe praktike. Në programe të tilla si: Informatika e Aplikuara dhe Teknik i Lartë për Laboratorët Mjekësorë, puna praktike ka prioritet të lartë duke filluar nga viti i parë. Kolegji Universitar “Logos” ofron një marrëveshje tutorimi për studentët, që siguron mbështetje të efektshme shtesë. Zyra e Këshillimit të Karrierës është aktive dhe krijon marrëdhënie të ngushta me të diplomuarit dhe punëdhënësit, duke ofruar mundësi për zhvillimin e praktikave, që shpesh çojnë drejtpërdrejt te punësimi i studentëve.



## **Gjetjet**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### **Dobësi**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

### **Pohim i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim të ndërmarrë.

## **Gjykimi**

**Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.**

## Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Të gjitha programet janë hartuar dhe përshkruar mbi bazë moduli, duke zhvilluar njohuritë, me ngarkesën e punës vjetore dhe semestrale, të ndara në lloje të ndryshme të leksioneve dhe klasave duke përfshirë praktikën. **[RVV fq. 33]** Orari mësimor përbëhet nga dy semestra në vit, secili nga 15 javë me së paku 23 orë mësimi në javë. **[3.3]** Informacioni për programin **[5.4a]** përfshin oraret mësimore sipas semestrit dhe kreditet e caktuara. Faqja e internetit përmban një seksion për secilin fakultet, ku përshkruhen programet dhe renditen modulet e marra në çdo vit me vlerën totale të krediteve për vitin në ECTS. **[faqja e internetit]** Programet Master Profesional me 90 kredite duhet të zëvendësohen me versione prej 60 kreditesh me qëllim përmbushjen e udhëzimeve të reja kombëtare. **[Dokumenti shtesë 3]** Studentëve u jepet informacion rreth programit të tyre të studimit në fillim të semestrit ose të vitit. **[M3; M7]** Manuali **[Dokumenti shtesë Manuali dhe kopja në format të shtypur e shqyrtuar gjatë vizitës]** i cili i prezanton studentët me institucionin Kolegji Universitar “Logos”, përfshin detajet e strukturës së programeve dhe informacionin rreth provimeve. Ka një periudhë maksimale studimi prej 10 vjetësh. **[3.3] [Kapitulli I Standard II.1]**

4.2 Programi hartohet nga profesorët dhe departamentet janë përgjegjëse për të siguruar që mësimdhënia ofrohet nga një staf i kualifikuar dhe me përvojë. Syllabuset rishikohen në fillim të çdo viti dhe nënshkruhen nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani i fakultetit. **[RVV fq.33; 5.4b]** Ndryshimet në programe diskutohen në Këshillin e Fakultetit dhe në Senat, dhe Dekani i raporton Rektorit. **[M2; Dokumenti shtesë 5 / 2-1]** Përmbledhjet e modulit përfshijnë qëllimet dhe objektivat, përmbajtjen, metodat e mësimdhënies, syllabusin dhe literaturën për lexim. Informacioni i modulit për kontabilitetin e kompjuterizuar, **[Dokumenti shtesë 11a; 11c]** që i është dhënë Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të Jashtëm si shembull, rendit temat që duhet të mbulojnë; dhe gjithashtu ka një listë të shkurtër të literaturës. **[Kapitulli I Standardi II. 1]**

4.3 Syllabuset për programet e Masterit Profesional përmbajnë detajet e modulit, duke përfshirë mënyrën e vlerësimit të modulit dhe koeficientin për çdo element të vlerësimit. Ato përfshijnë se çfarë synon të mbulojë çdo modul, duke u përqendruar te njohuritë dhe jo tek aftësitë akademike të tilla si vlerësimi ose mendimi kritik. Përmbledhjet e syllabuseve përfshijnë literaturën bazë. **[5.4b]** Literatura për programin Master “Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë” përmban 18 libra me datat e botimit (ku është e disponueshme) nga viti 2009 në vitin 2017, dhe shumica prej tyre janë në gjuhën angleze. Modulet mund të përfshijnë edhe literaturën e tyre, zakonisht një ose dy libra, edhe pse disa nuk i përfshijnë. Këta janë më shpesh në gjuhën shqipe, ose janë libra më të vjetër, si për shembull nga vitet 1990. **[5.4b] [Kapitulli I Standardi II.1]**

4.4 Literatura bazë është në gjuhën shqipe plotësohet me informacion nga pedagogu. **[Dokumenti shtesë 3]** Sekretaria iu ofron studentëve kopje të “mësimeve të planifikuara paraprakisht”. b) Ka një bibliotekë me më shumë se 2,000 libra **[M8; vizita në terren]** në të cilin vetëm 125 janë në gjuhën shqipe dhe më shumë se 270 në gjuhën angleze. Pjesa më e madhe (më shumë se 1,600) janë në gjuhën greke dhe shumë prej tyre nuk lidhen me programet e ofruara aktualisht, të cilat përfshijnë klasikët e lashtë grekë, teologjinë dhe sociologjinë. Megjithatë stafi i Kolegjit Universitar “Logos” shpjegoi se do të kërkohen kur të themelohet fakulteti i tretë i planifikuar, kjo redukton ndjeshëm literaturën në dispozicion të studentëve të tanishëm. Vetëm 89 punonjës dhe studentë nga më shumë se 300 kanë kartelë biblioteke që kërkohet për të marrë një libër. **[M8; vizita në terren]** Edhe pse është e mundur të përdoren libra në bibliotekë pa kartë **[M8]** orari i punës është vetëm 8: 30 paradite deri në 4: 00 pasdite, nga e hëna në të premte dhe mbyllet në gusht; **[vizita në terren 3.11]**,

gjë që sugjeron se biblioteka nuk ofron shumë mundësi për ta frekuentuar; kjo gjetje mbështet dobësinë dhe rekomandimin e identifikuar në pikën 4.5. **[Kapitulli I Standardi II.1]**

4.5 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi disponueshmërinë dhe përdorimin e burimeve elektronike. Personeli deklaroi se ata i udhëzojnë studentët drejt burimeve të informacionit me bazë në internet **[M8]**, por studentët parapëlqejnë libra në format të shtypur. Si rrjedhojë, Kolegji Universitar “Logos” po kërkon ta shtojë fondin e bibliotekës së tij, por gjithashtu po negocion edhe për të ofruar akses në katalogët online **[M8]**. Nuk kishte asnjë provë të përdorimit të bibliotekës elektronike të Universitetit të Pireut, të përmendur në RVV **[RVV fq. 16; 3.11; M2 M3; M4; M7]** dhe linku i saj në internet nuk funksionon **[faqja e internetit]**, edhe pse Universiteti ka dhuruar një numër të konsiderueshëm librash në format të shtypur **[vizita në terren]**. Nëse personeli kërkon libra, të cilat mund të jenë në përgjigje të reagimit të studentëve, është e mundur që të ofrohen. **[M8]** Megjithatë, mirëmbajtja e një biblioteke me libra në format të shtypur në nivelin e kërkuar paraqet një sfidë, dhe studentët gjithashtu duhet ta dinë si t'i përdorin burimet elektronike të literaturës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e sheh furnizimin e kufizuar të librave bazë në gjuhën shqipe, aksesin e kufizuar në burimet e bibliotekave elektronike dhe përdorimin e kufizuar të bibliotekës nga ana e studentëve, si një dobësi dhe rekomandon që Kolegji Universitar “Logos” të zbatojë një strategji për të siguruar shërbimin e bibliotekës dhe përdorimin e qëndrueshëm si për librat në format të shtypur (veçanërisht në gjuhën shqipe) dhe burimet elektronike brenda nëntë muajsh nga marrja e raportit përfundimtar. Kjo gjetje mbështetet edhe nga komentet e dhëna në pikën 5.5. **[Kapitulli I Standardi II.1]**

4.6 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pa laboratorët dhe sallat e kompjuterëve për programet e informatikës dhe teknikun e laboratorit mjekësor, si dhe sallat e leksioneve dhe seminareve **[vizita në terren]**. Studentët raportuan se këto janë të përshtatshme për nevojat e tyre **[M3; M4]** dhe se kur ata kanë pasur shqetësime në lidhje me disponueshmërinë e pajisjeve, ata janë ankuar dhe këto çështje janë zgjidhur. U blenë më shumë mikroskopë dhe u ofruan më shumë kompjuter. **[M3]** Punëdhënësit që i marrin studentët si stazhierë dhe disave prej tyre u kanë dhënë edhe punë të përhershme, kanë konfirmuar se pajisjet që përdorin dhe testet laboratorike që ata janë të trajnuar për të kryer, pasqyrojnë se çfarë do të bëjnë në vendin e punës. **[M6] [Kapitulli I Standardi II.1]**

4.7 Staf i emërohet për të mbushur boshllëqet në ofrimin e mësimdhënies sapa të jenë bërë të njohura kërkesat për vitin. **[M2; M7]** Kjo shpesh përfshin stafin me kohë të pjeshme të cilët janë të punësuar në fusha profesionale si laboratorët mjekësorë dhe të cilët mund të ofrojnë informacione bashkëkohore në mësimdhënien e tyre. **[M2; M7] [Kapitulli I Standardi II.1]**

4.8 Stazhi ofrohet në programet e ciklit të parë dhe të ciklit të dytë. **[M3; M4; M6]**. Ka marrëveshje formale me kompanitë, që përfshijnë vlerësimin e studentëve nga punëdhënësi në lidhje me pjesëmarrjen, interesin dhe mësimnxënien aktive. **[Dokumenti shtesë 11.5; Dokumenti shtesë 11.6; M5]** Studentët e financës dhe të kontabilitetit e kryejnë stazhin në banka **[Dokumenti shtesë 11.7]** ndërsa studentët e biznesit në disa kompani, duke përfshirë hotelet, drejtorinë e tatimeve dhe një kompani reklamash. **[Dokumenti shtesë 11.4]** Pjesa më e madhe e punëdhënësve japin vlerësime të larta për studentët **[Dokumenti shtesë 11.4]** dhe ata thonë fjalë pozitive për aftësitë që zhvillojnë studentët, të cilat besojnë se do t'i bëjnë punonjës të mirë pasi të diplomohen. **[M6]** Gjatë stazhit, studentët kryejnë një raport të përvojave të tyre **[M3]**, dhe aluminit e pohojnë vlerën e kësaj dhe pranojnë se punët duhet të merren në meritë. **[M6] [Kapitulli I Standardi II.1]**

4.9 Programi i Masterit Profesional në Teknikë të Lartë Laboratorësh Mjekësorë përfshin një stazh dymujor: **[Dokumenti shtesë 8]** një deklaratë përcakton se çfarë pritet nga studenti dhe çfarë duhet të përfitojë studenti nga përvoja. Studentët teknikë të laboratorëve mjekësorë i tërheq Kolegji Universitar “Logos”, sepse institucioni ofron punë

praktike që në vitin e parë të studimit. **[M3; RVV fq.33]** Stazhi profesional është i disponueshëm si pjesë e planit mësimor në programin e Masterit Profesional në financë dhe kontabilitet. RVV-ja tregon se është përgatitur një plan praktikash mësimore me kompaninë pritëse dhe ai ndiqet nga një anëtar i stafit akademik; **[RVV fq.33; 3.6]** dhe kjo vlerësohet nga mentori i kompanisë së biznesit dhe më pas certifikohet. **[Dokumenti shtesë 11.5; Dokumenti shtesë 11.6; M3; M6]** Studentët e vlerësojnë shkallën e lartë të punës praktike e cila integrohet me teorinë. **[M4] [Kapitulli I Standardi II.1]**

4.10 Studentët mbështeten më tej për të zhvilluar aftësi profesionale nëpërmjet projektit ose tezës së tyre. Një konferencë studentore e mbajtur në vitin 2017 u dha mundësinë ta paraqisnin punën e tyre para njëri-tjetrit dhe të diplomuarve. **[M2; M3; M4; M6]** Studentët ishin të mendimit se kjo ishte diçka e vlefshme; temat kishin rëndësi aktuale për shoqërinë duke përfshirë lehtësimin sasiar, malarien dhe përdorimin e kompjuterëve për të përmirësuar analizën e mostrave mjekësore dhe për t'i regjistruar studentët online. **[M3; 7.4]** Seminaret e promovuara nga ZKK-ja synojnë gjithashtu të mbështesin ndërgjegjësimin e studentëve për veprimtarinë kërkimore; temat përfshinin SIDA-n dhe lëndët narkotike, sistemet e taksave, zhvillimin e qëndrueshëm dhe komunikimin kulturor. **[Kapitulli I Standardi II.1]**

4.11 Kolegji Universitar monitoron normat e punësimit. **[M7]** Përqindja e të personave të diplomuar në Teknikë të Lartë Laboratorësh Mjekësorë ka ndryshuar nga 100 për qind e grupit të të diplomuarve në vitin 2013, në 33 për qind në vitin 2014 dhe 53 për qind në vitin 2016. **[Dokumenti shtesë 7a]** Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu dha një listë e punësimit për të diplomuarit e degës së financës, kontabilitetit dhe të diplomuarve në biznes **[Dokumenti shtesë 7b]**. Vetëm 2.5 për qind janë të papunë, 30 për qind po ndjekin studimet Master dhe pjesa tjetër janë të punësuar në biznese familjare, kompani private dhe administratë publike. Studentëve në programin e kontabilitetit kompjuterik u ofrohen trajnime në industrinë e softuerit që iu ofron atyre më shumë mundësi punësimi. **[3.2; RVV fq.33] [Kapitulli I Standardi II.1]**

4.12 Ka rregullore për vlerësim në nivel shkolle dhe fakulteti. **[RVV fq. 34; 3.4; 3.5]** Kryerja e provimeve menaxhohet në mënyrë të sigurt. **[3.2]** Studentët mund të marrin shpjegime lidhur me provimet e tyre për të gjetur se çfarë kanë bërë saktë ose çfarë kanë bërë gabim **[M3]** dhe mund të përdorin gjithashtu një proces formal për ta ankimuar notën. Studentët janë në dijeni të këtij procesi **[3.2; M3; M4]**, por nuk e përdorin shumë pasi zakonisht ata sigurohen për përshtatshmërinë e notës së tyre kur një pedagog u dërgon shpjegimet përkatëse. **[M3] [Kapitulli I Standardi II.2]**

4.13 Rezultatet e provimit publikohen dhe ka rregulla të qarta për dhënien dhe ridhënien e provimeve. **[3.3]** Studentët kanë të drejtë të rivlerësohen deri në tre pikë në vit për të përmirësuar rezultatet. **[M3; 3.3]** Raporti i periudhës 2015-2016 **[Dokumenti shtesë 3]** thekson se përqendrimi i këtij viti ishte zhvillimi i kurrikulës, i cili rezultoi në një skemë standarde vlerësimi me 30 për qind nga provimi paraprak, 60 për qind nga provimi në fund të semestrit dhe 10 për qind nga seminarët. Kjo rishikoi koeficientet në rregulloret e përgjithshme. **[3.3]** Ka një kërkesë për frekuentimin në nivel 75 për qind, si kusht për lejimin e studentëve për t'u pranuar në provime. **[3.3; 3.4; 3.5, Dokumenti shtesë 3]** Studentët mbrojnë tezën e diplomës së tyre para një Komisioni Vlerësimi. **[5.5] [Kapitulli I Standardi II.2]**

4.14 Pikët e dhëna si përqindje konvertohen në nota në një shkallë 1-10 **[3.3]** nga të cilat Kolegji Universitar llogarit notat mesatare të ponderuara bazuar në formulën kombëtare. Manuali i studentëve **[Dokumenti shtesë Manuali dhe kopja në format të shtypur e shqyrtuar gjatë vizitës]** detajon konvertimin e përqindjes së notave për notat 4-10, së bashku me proceset për transferimin në fillim dhe në mes të programeve, kërkesën për frekuentimin në nivel 75 për qind, të drejtën për të ankimuar një notë dhe procedurat disiplinore. Ai gjithashtu shpjegon kërkesën për reregjistrimin dhe procesin e ndërprerjes së

studimit. Studentët i marrin notat nga një anëtar i stafit akademik përgjegjës për modulin dhe notat konfirmohen nga një listë zyrtare notash lëshuar nga Sekretaria. Ministria ka miratuar formatin e Suplementit të Diplomës. **[5.5] [Kapitulli I Standardi II.2]**

4.15 Raporti 2015-2016 **[Dokumenti shtesë 3]** paraqet të dhënat e kalimit / ngeljeve. Normat mesatare të kalueshmërisë për ciklin e parë ndryshonin nga 66 për qind në departamentin e menaxhimit të biznesit, në 71 për qind te departamenti i turizmi dhe 94 për qind te departamenti i biznes/kontabilitet; programet e ciklit të dytë kishin norma kalimi prej 99 për qind (teknik mjekësor) dhe 98 për qind (ekonomik). Megjithatë, ka një ndryshim të konsiderueshëm midis viteve të studimit dhe semestrave në disa programe. **[Dokumenti shtesë 3]** Kur detyra e studentit vlerësohet me notë, ajo verifikohet nga disa persona për t'u siguruar që është notë e saktë dhe nevojiten katër nënshkrime, por detyra nuk vlerësohet në mënyrë anonime **[vizita në terren]**. Grupi e konsideroi **dobësi** faktin që nuk ka sistem për sekretimin anonim të provimeve dhe për këtë arsye **rekomandon** që Kolegji Universitar "Logos" të nisë sekretimin anonim të provimeve menjëherë pas marrjes së raportit përfundimtar. **[Kapitulli I Standardi II.2]**

4.16 Përshtypjet e studentëve jepen nëpërmjet përfaqësuesve të studentëve në Borde, duke përfshirë NjSBC-në, Senatin Akademik dhe Këshillin e Etikës. **[M3; M4]** Këshilli Studentor zgjidhet **[3.3]** dhe ka qenë i efektshëm lidhur me çështjen e marrjes së pajisjeve mjekësore laboratorike të përmirësuar dhe më shumë kompjuterë për bibliotekën. **[M3; M4]** Këshilli përfshihet në administrimin e anketimeve për reagimet e studentëve **[M3]** dhe RVV-ja thotë se pikëpamjet e studentëve merren parasysh në sigurimin e cilësisë. **[RVV fq.36, fq.9.]** U bë një kërkesë nga një grup studentësh në programin e teknikut të lartë të laboratorëve mjekësorë për të zëvendësuar disa lëndë joprofesionale me ato profesionale; u ngrit një grup pune për të shqyrtuar shqetësimet e tyre dhe studentët **[Dokumenti shtesë 5 / 2-1]** dhanë falënderimet e tyre për ndryshimet e bëra. Ndryshime të tjera përfshijnë ndryshimin e datave të provimeve për t'u mundësuar studentëve që të menaxhojnë ngarkesën e tyre të punës dhe reduktimin e përmasave të grupeve. **[M3] [Kapitulli I Standardi II.1, Kapitulli I Standardi II.3, Kapitulli I Standardi II.4]**

4.17 Kolegji Universitar "Logos" synon të përvetësojë qasje bashkëkohore ndërvepruese në mësimdhënie. **[3.4; 3.5]** Stafi është i përkushtuar në mësimdhënien e tyre dhe studentët mendojnë shumë pozitivisht për të. Ata e vlerësojnë veçanërisht faktin që nxiten të diskutojnë **[M3; M4]** dhe gatishmërinë e stafit për të gjetur kohë për t'iu kthyer gjërave ku ata gjejnë vështirësi. **[M3]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dëgjoi një shembull se si një anëtar i stafit përshtatet në mësimdhënie ndaj stilit të të nxëniet të studentëve, dhe studentëve që nuk arrijnë të përfitojnë plotësisht nga leksionet, mund t'u ofrohet studim i pavarur. **[M7] [Kapitulli I Standard II.1, Kapitulli I Standard II.3, Kapitulli I Standard II.4]**

4.18 Zyra e Këshillimit të Karrierës (ZKK) mbledh të dhëna nga të diplomuarit rreth punësimit të tyre **[12.6; Dokumenti i shqyrtuar gjatë vizitës]** dhe mban kontakt me alumnit. Një shoqatë alumnish është në proces krijimi **[M6]** dhe **[Dokumenti shtesë 3; dokument i shqyrtuar gjatë vizitës]**, bashkë me një bazë të dhënash informacioni rreth punësimit të të diplomuarve. Sidoqoftë, nuk ka dëshmi se këto informacione përdoren për të përmirësuar programet dhe stafi nuk ishte në gjendje t'i vërtetonte Grupit të Vlerësimit të Jashtëm që kishte përmirësim të tillë. **[M2; M8; M7]** Punëdhënësit dhe alumnit nuk kanë mundësi të japin reagime për programet bazuar në përvojën e tyre. **[M6]** Të dhënat e punësimit të të diplomuarve dhe reagimet nga punëdhënësit dhe alumnit nuk përdoren për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve dhe kjo gjetje mbështet dobësitë dhe rekomandimet e identifikuara në pikën 4.20. **[Kapitulli I Standardi II.3]**

4.19 Fakultetet janë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies **[3.2]**, por mësimdhënia monitorohet nga "autoritetet menaxhuese". **[RVV, fq.36]** NjSBC-ja autonome, e cila i raporton drejtpërsëdrejti Rektorit **[3.2; 3.6]** dhe përfshin një përfaqësues studentësh, **[M3]** si

dhe përgatit raporte [8.7] duke përmbledhur reagimet e dhëna nga studentët. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi raportet e NjSBC-së për programin e Masterit Profesional në Financë dhe Kontabilitet dhe për studimet e ciklit të parë në Fakultetin Ekonomik. [8.8; 8.7] Studentët plotësojnë anketimin kombëtar për kompetencat e pedagogëve [3.2, M2, M3, M4 dokumentet e ofruara gjatë vizitës së dokumenteve të anketimit] dhe raporti i 2015-2016 [Dokumenti shtesë 3] vëren që 77.5 për qind e stafit janë vlerësuar të efektshëm. Të dhënat e frekuentimit merren gjithashtu në shqyrtim. [M8] Megjithatë, nuk ka një plan veprimi që lidhet me raportet e NjSBC-së dhe stafi nuk mund të ofrojë dëshmi për ndonjë ndjekje sistematike të raporteve për të siguruar që çështjet të trajtohen dhe të bëhen përmirësimet si rrjedhojë e të dhënave. [M2; M7] Personeli individual mund ta përdorë informacionin për të reflektuar dhe për ta përmirësuar praktikën e tij [M7], por kjo as nuk mbështetet dhe as nuk monitorohet. Nuk ka ndjekje sistematike të veprimeve në përgjigje të të dhënave të anketimit dhe kjo gjetje mbështet dobësitë dhe rekomandimet e identifikuara në pikën 4.20. [Kapitulli I Standardi II.3, Kapitulli I Standardi II.4]

4.20 Lidhur me vëzhgimet në pikat 4.18 dhe 4.19, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si një **dobësi** mungesën e një procesi formal për sigurimin dhe monitorimin e përmirësimit të cilësisë bazuar në të dhënat e anketimit të studentëve dhe në të dhënat e punësimit të të diplomuarve dhe mungesën e një procesi për punëdhënësit dhe alumnit që të informojë dhe të japë feedback për zhvillimin e programeve. Grupi **rekomandon** që Kolegji Universitar “Logos” të krijojë një proces të monitoruar nga NjSBC-ja për përmirësimin e programeve në përgjigje të të dhënave të anketimit të studentëve, të dhënave të punësimit dhe reagimet nga punëdhënësit dhe alumnit, brenda 12 muajve nga marrja e raportit përfundimtar. [Kapitulli I Standardi II.3, Kapitulli I Standardi II.4]

4.21 Qendra për Kërkim dhe Zhvillim Shkencor i raporton Senatit [RVV fq.11; M2] dhe drejtohet nga përgjegjësi i qendrës që ka gradën Doktor. [7.2; M2] Ndonëse gjendet në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, [3.3] ajo ka një kompetencë të gjerë institucionale dhe punon edhe me Fakultetin Ekonomik. [M2] Qendra është përgjegjëse për nxitjen e zhvillimit të kërkimit shkencor. [7.2] Ajo [RVV fq. 38] koordinon dhe organizon veprimtari dhe ndërveprime midis pjesëve të ndryshme të Kolegjit Universitar në lidhje me kërkimin, ndërsa departamentet janë të rëndësishme për veprimtarinë kërkimore operative. [M2] Ndërsa Qendra është njësi kryesore e organizimit të mësimdhënies dhe kërkimit, [RVV fq.37; 3.1; 3.6; M2] planifikimi i kërkimit shkencor është ndërmarrë në konsultim me përgjegjësit e departamentit. Departamentet kanë planet e tyre kërkimore, [7.4, 7.5, M2] të cilat përfshijnë zhvillimin e mësimdhënies nëpërmjet kërkimit, botimeve të stafit dhe pjesëmarrjes në konferenca; dhe përgjegjësit e departamenteve raportojnë për ecurinë e planeve. [Kapitulli II Standardi I.1, Kapitulli II Standardi I.2]

4.22 Në 2015-16 Qendra për Kërkim dhe Zhvillim Shkencor [Dokumenti shtesë 3] synoi rritjen e nivelit të kërkimit të personelit dhe veprimtarive të projekteve, për të aplikuar të nxënit teorik të studentëve në ekonominë vendore dhe për të rritur lidhjet me universitetet e huaja. Dyzet e gjashtë studentë morën pjesë në kërkim kundrejt një objekti prej 40 studentësh. Nuk u arrit qëllimi lidhur me angazhimin e studentëve në veprimtarinë kërkimore, dhe as synimi i rritjes së numrit të çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Bashkëpunimi me Universitetin e Pireut synonte të mbështeste kërkimin shkencor [3.2] dhe bashkëpunimet e mëtejshme të planifikuara në Greqi, Kretë dhe Qipro kanë të njëjtin synim. [RVV fq.40] [Kapitulli II Standardi I.2]

4.23 Kolegji Universitar “Logos” mbështet ndërveprimin kërkimor me organizata të tjera, duke ofruar mbështetje administrative për konferenca në Tiranë. [M7] Një konferencë ndërkombëtare u mbajt në Tiranë për shkencën e aplikuar dhe ekonominë në vitin 2017, [7.14] dhe në një shkollë verore janë mbajtur leksione të hapura [7.8] me kolegë nga Rumania dhe Greqia, veçanërisht nga Universiteti i Pireut. [7.12] U mbajt një konferencë me Universitetet e Tiranës dhe Prishtinës lidhur me sfidat e emigrimit. [M7] Në 2015-2016, 13

punonjës paraqitën postera në konferenca dhe 7 të tjerë dhanë prezantime. **[Dokumenti shtesë 9]** Personeli nga Kolegji Universitar “Logos” është përfshirë në një projekt të financuar nga Erasmus për lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë dhe të drejtave të njeriut - sfidë e re arsimore për Shqipërinë **[RVV fq. 38]** - dhe në 2015-2016, 10 pjesëtarë të stafit u përfshinë në një projekt të financuar nga programi ndërkuftar Greqi-Shqipëri për krijimin e destinacioneve të turizmit ekologjik. **[7.11; Dokumenti shtesë 9]** Kjo vërteton disa lidhje ndërkombëtare dhe evropiane. Kolegji Universitar përmendi projektin e ekoturizmit dhe leksionet e hapura si shembuj të përdorimit të kërkimit shkencor në të mirë të komunitetit. **[RVV fq.40] [Kapitulli II Standardi I.2, Kapitulli II Standardi I.3]**

4.24 Nuk ka mbështetje financiare për shpenzimet e udhëtimit ose akomodimit apo për tarifat e konferencave në lidhje me veprimtarinë kërkimore të stafit. **[M2; M7]** Kjo kufizon shtrirjen e mbështetjes financiare për veprimtarinë kërkimore dhe shkallën në të cilën personeli i Kolegjit Universitar “Logos” në praktikë mund të ndërveprojë me organizata të tjera. Marrëveshja me Universitetin e Pireut **[marrëveshja - dokumenti i ofruar gjatë vizitës, 3.2, 7.13]** përqendrohet gjerësisht në mobilitetin dhe ndryshime, por ndërveprimet aktualisht janë të kufizuara në veprimtarinë e një shkolle verore në Tiranë, **[M2]** gjë që kufizon vlerën e saj për mobilitetin. **[M2]** Nuk ka dëshmi për mobilitet të konsiderueshëm për studentët. Bisedimet me një universitet në Greqi për të siguruar bursa për studentët e Masterit nga Kolegji Universitar “Logos” për të udhëtuar në Greqi **[M5]** nuk janë përfunduar. Studentët e vitit të dytë kanë pyetur për mundësinë e shkëmbimeve në Universitetin e Pireut në vitin e tyre të tretë gjatë 2017-2018 **[M3]** dhe po presin një përgjigje. Nuk ka mbështetje financiare për mobilitetin e tyre **[M7]** dhe nuk ka prova se Kolegji Universitar “Logos” po përdor fonde të disponueshme përmes skemës Erasmus për të mbështetur mobilitetin e studentëve. Përkundër synimeve të Kolegjit Universitar, mobiliteti ndërkombëtar u shënuar si një **dobësi** në analizën SWOT në RVV **[RVV]** dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pajtohet me këtë analizë. Këto gjetje mbështesin dobësitë dhe rekomandimet e identifikuara në pikat 1.12. **[Kapitulli II Standardi I.1, Kapitulli II Standardi I.2, Kapitulli II Standardi I.3, Kapitulli II Standardi I.6]**

4.25 Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu tha se nuk ofrohet mbështetje financiare për mobilitetin e stafit ose studentëve dhe për udhëtimin në konferencat shkencore, sepse tarifat e studentëve në Kolegjin Universitar “Logos” janë të ulëta; **[M2; M5]** megjithatë, grupi u vu në dijeni për bujarinë e Fondacionit në aspekte të tjera për të mbështetur misionin e Kolegjit Universitar. **[M2; M7; M8]** Kjo mbështet si dobësitë ashtu edhe rekomandimet e identifikuara në pikat 1.12. **[Kapitulli II Standardi I.1, Kapitulli II Standardi I.2, Kapitulli II Standardet I.3, Kapitulli II Standardi I.6]**

4.26 Kolegji Universitar planifikon veprimtaritë kërkimore në konsultim me drejtuesit e departamentit dhe kjo përfshin organizimin e konferencave, arkivimin e punës kërkimore të stafit dhe planifikimin e ndarjes së fondeve në fushat prioritare të veprimtarisë. **[RVV p, 38; 7.2; M2]** Megjithëse Qendra Kërkimore bashkërendon kërkimet institucionale dhe identifikon disa fusha prioritare, kërkimi individual është më me rëndësi dhe më produktiv. **[M7]** **[Kapitulli II Standardi I.4]**

4.27 Kolegji Universitar “Logos” e ka pasur të vështirë për të rekrutuar staf me kualifikim të lartë **[M2; 3.2]** dhe stafi që nuk ka Doktoraturë, nxitet që ta marrë. **[M2]** Stafit me kohë të plotë i jepet kohë nga ngarkesa e tyre mësimore për të marrë një Doktoraturë **[RVV fq.19]** ose të marrë pjesë në një konferencë, ndërsa stafi me kohë të pjesshme duhet të gjejë kohë brenda angazhimeve të tyre të mësimdhënies. **[M7]** Përmirësimi i kualifikimeve të stafit akademik mbetet një prioritet për Kolegjin Universitar “Logos”. **[RVV, fq.39]** Ka një ndërveprim me organizatat ndërkombëtare: në 2016-2017 ka pasur bashkëpunim me dy institucioneve shqiptare dhe dy të huaja që përfshijnë një total prej 10 pjesëtarë të stafit të Kolegjit Universitar “Logos”. **[GID]** Megjithatë, mungesa e mbështetjes financiare për veprimtarinë kërkimore të stafit (shih gjithashtu pikat 4.24-4.25) mund të prekë stafin më të ri

që kërkon të marrë kualifikime dhe do të reduktojë veprimtaritë kërkimore. Kjo gjetje mbështet dobësinë e parë dhe rekomandimin e identifikuar në pikat 1.12. **[Kapitulli II Standardi I.5, Kapitulli II Standardi I.6, Kapitulli II Standardi I.8]**

4.28 Qendra për Kërkim dhe Zhvillim Shkencor boton një revistë të Kolegjit Universitar "Logos" në të cilën stafi mund të publikojë kërkimet e tyre, për shembull duke paraqitur përmbledhje të dokumenteve të konferencës. **[7.10]** Në 2015-16, 24 punonjës botuan artikuj në revistë. **[Dokumenti shtesë 9]** Me kalimin e viteve janë prodhuar gjithsej në total 173 artikuj dhe botime, në revistat shqiptare **[GID]**; rritja e botimeve është një prioritet për Kolegjin Universitar "Logos". **[RVV, fq.39]** Një nga qëllimet e Qendrës për 2015-16 **[Dokumenti shtesë 3]** ishte rritja e botimit të revistës PHS të Logos dhe botimeve të tilla si monografi dhe materiale mësimore. **[Kapitulli II Standardi I.7]**

4.29 Një prioritet për kërkimin shkencor në strategjinë 2012-17 ishte botimi i librave për studentët, gjë që do të rriste transmetimin e njohurive dhe rezultateve të kërkimit **[3.2]**, por analiza SWOT e përgatitur nga Kolegji Universitar e njeh këtë si një fushë që kërkon zhvillim të mëtejshëm. **[RVV]** Nuk ka kërkim në lidhje me partnerët që ofrojnë praktika studentore edhe pse punëdhënësit konsiderojnë se mund të ketë hapësirë për këtë **[M6]** dhe Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu tha se kërkimi bashkëpunues është një fushë zhvillimi. **[M7]** **[Kapitulli II Standardi I.8]**

4.30 Stafi akademik në Kolegjin Universitar "Logos" është i përkushtuar për të mbështetur mësimnxënien e studentëve dhe studentët janë të kënaqur që mund të marrin ndihmë dhe mbështetje në studimet e tyre kur kanë nevojë. Programet janë përshkruar qartë dhe janë në përputhje me sistemin e Bolonjës. Studentët kanë akses në informacion rreth studimeve të tyre dhe programet e tyre janë në përputhje me mundësitë e punësimit vendor me elementë të rëndësishëm të punës praktike. Stafi me kohë të pjeshme të cilët janë gjithashtu të punësuar në vendet e punës përkatëse, sjellin këtë përvojë në mësimdhënien e tyre. Studentët e shikojnë stafin si mbështetës dhe të dobishëm dhe orët mësimore i konsiderojnë ndërvepruese. Ata kanë akses në stazhe që u japin atyre një kuptim të botës së punësimit dhe punëdhënësit kanë vlerësim shumë pozitiv për njohuritë që kanë përveçësuar studentët. Sidoqoftë, fondi i bibliotekës është shumë i kufizuar, veçanërisht në lidhje me burimet elektronike. Provimet nuk vlerësohen në mënyrë anonime me notë. NjSBC-ja prodhon raporte të bazuara në anketimet e studentëve dhe ZKK-ja mbledh të dhëna për punësimin e të diplomuarve, por nuk ka mjete sistematike për këtë që të inkuadrohen në përmirësimin e programit dhe raportet e NjSBC-së nuk përfshijnë një plan veprimi. Kjo do të thotë se ka dobësi në proceset për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe për zhvillimin e programeve. Nuk ka asnjë mundësi që alumnit apo punëdhënësit të japin reagimet dhe mendimet bazuar në përvojën e tyre për të mbështetur zhvillimin e programeve.

4.31 Kërkimet koordinohen nga Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit Shkencor, por kryesisht kryhen nga individë me mbështetje nga departamentet. Personeli përkrahet për të marrë Doktoraturën; ka shembuj të veprimtarisë kërkimore në bashkëpunim me organizatat e tjera dhe angazhimin në projekte me institucione të tjera. Megjithatë, kjo është e kufizuar dhe shumica e veprimtarisë është e bazuar në Tiranë, me botime në Shqipëri. Nuk ka fonde për veprimtarinë kërkimore të stafit, përfshirë udhëtimin në konferenca dhe mobilitete të tjera. E vetmja lidhje aktive është me Universitetin e Pireut, që përfshin një shkollë verore në Tiranë dhe sigurimin e disa librave të bibliotekës. Pavarësisht nga kërkesat e studentëve, nuk ka akses në financimin e Erasmus-it dhe aktualisht nuk ka mobilitet të studentëve.



## Gjetjet

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme :

- fondi i kufizuar i librave bazë në gjuhën shqipe, akses i kufizuar në burimet e bibliotekave elektronike dhe përdorimi i kufizuar i bibliotekës nga studentët (pikat 4.5, 4.4 dhe 5.5, **Kapitulli I Standardi II.1, Kapitulli I Standardi III.5**)
- nuk ka sistem për sekretimin e fletëve të provimeve (pika 4.15; **Kapitulli I Standardi II.2**)
- mungesa e një procesi formal për sigurimin dhe monitorimin e përmirësimit të cilësisë bazuar në të dhënat e anketimit të studentëve dhe të dhënat e punësimit të të diplomuarve, dhe mungesa e një procesi që punëdhënësit dhe të diplomuarit, të japin komentet dhe reagimet e tyre, në mbështetje të zhvillimit të programeve (pikat 4.20, 4.18 dhe 4.19, **Kapitulli I Standardi II.3, Kapitulli I Standardi II.4**)

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi rekomandimet e mëposhtme :

- që Kolegji Universitar “Logos” të zbatojë një strategji për të përmirësuar shërbimin që ofron biblioteka dhe për të siguruar përdorimin e njëtrajtshëm si të stokut të librave të shtypur (veçanërisht në gjuhën shqipe) ashtu edhe të librave elektronikë, brenda 9 muajve nga marrja e raportit përfundimtar (pikat 4.5, 4.4 dhe 5.5, **Kapitulli I Standardi II.1, Kapitulli I Standardi III.5**)
- që Kolegji Universitar “Logos” të zbatojë sekretimin anonim të provimeve menjëherë pas marrjes së raportit përfundimtar (pika 4.15; **Kapitulli I Standardi II.2**)
- që Kolegji Universitar “Logos” të krijojë një proces të monitoruar nga NjSBC-ja, për përmirësimin e programeve në përgjigje të të dhënave të anketimit të studentëve, të dhënave të punësimit dhe reagimeve nga punëdhënësit dhe alumni, brenda 12 muajve nga marrja e raportit përfundimtar (pikat 4.20, 4.18 dhe 4.19, **Kapitulli I Standardi II.3, Kapitulli I Standardi II.4**)

### Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim të ndërmarrë.

### Gjykimi

**Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.**

## Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Kolegji Universitar “Logos” ka përcaktuar qartë në statut dhe në rregulloret e brendshme të Kolegjit kriteret e pranimit për studentët **[3.1 fq. 15; 3.3 neni 39; 3.4; 3.4, 3.2 fq. 19]**, si dhe i ka publikuar ato në faqen e internetit të kolegjit **[www.shlplogos.edu.al]**, të cilat mund të jenë të dobishme për studentët. Kolegji, përveç marketingut në mediat sociale, organizon fushata promovuese në TV dhe jep informacionin kryesor përmes fletëpalosjeve dhe një udhëzuesi për studentët. **[vizita në terren, udhëzues për studentët, dokument shtesë 2015-2016]** Kolegji Universitar “Logos” organizon takime promovuese me shkollat e mesme në rrethet e Tiranës, Beratit, Urës Vajgurore, Lushnjës dhe qytete të tjera. Disa studentë shoqërohen nga një anëtar i familjes kur paraqiten për të vlerësuar institucionin dhe programet. **[M8]** Pas regjistrimit, studentët priten nga stafi akademik i departamentit dhe u bëhet një prezantim i programeve të tyre. Studentët konfirmuan se informacioni që kishin marrë para regjistrimit ishte i saktë dhe i përmbushte pritshmëritë e tyre. **[M3; M4]** Oraret vendosen në këndet e njoftimeve në çdo kat. **[vizita në terren]** Studentët e vitit të dytë ose të tretë mund të luajnë një rol ndihmës për studentët e rinj të regjistruar në orientimin dhe familjarizimin e tyre. Në ditën e parë të studimeve të tyre, studentët regjistrohen pranë Sekretarisë dhe nënshkruajnë kontratën e tyre me kolegjin **[vizita në terren, 5.3.c]** sipas një plani të veçantë për regjistrim. Studentët nga diaspora ndjehen të kënaqur nga pritja që marrin ditën e parë të studimeve të tyre. **[M3]** Raporti i stafit akademik me studentët është më pak se 1:12. **[5-4c; 5-4d; 6-4; dokument shtesë 1.1] [Kapitulli I Standardi III.1]**

5.2 Kolegji Universitar “Logos” krijoi Zyrën e Këshillimit të Karrierës në vitin 2014 dhe e ristrukturoi atë në vitin 2017. **[Vendim Senati nr.3, datë 25 janar 2017]** ZKK-ja është përgjegjëse në dhënien e informacionit për studentët e ardhshëm rreth Kolegjit Universitar “Logos” gjatë takimeve të shkollave të mesme, **[M3, M4, M5; M7, M8]** përmes broshurave dhe fushatave mediale **[12.2 fq.2]** (shih gjithashtu pikën 5.1). Gjithashtu, Kolegji Universitar “Logos” angazhon pedagogët si mentorë për të mbështetur studentët e rinj. **[M7]** Departamentet kanë një rol të rëndësishëm në tërheqjen e studentëve të rinj në programet e tyre (shih gjithashtu pikën 5.1). **[M7; M2]** Përveç kësaj, kolegji përdor faqen e tij të internetit dhe këndet e njoftimit në fakultete dhe departamente për t'i garantuar studentëve informacionin që u nevojitet javë pas jave. Kolegji Universitar “Logos” ka një sistem efikas informacioni për ruajtjen e informacionit personal të studentëve **[vizita në terren]** dhe studentët kanë adresa elektronike të cilat administrohen nga Sekretaria. **[RVV fq. 41-42]** Çdo departament ka arkivin e tij. **[vizita në terren] [Kapitulli I Standardi III.2]**

5.3 Kolegji Universitar “Logos” ka një kuadër për udhëheqjen dhe këshillimin e studentëve, **[3.2; 3.3 neni 29; 3.3 neni 39; 12.2; 12.6; 3.4; 3.5; 3.9 fq. 3]** i cili përfshin një sistem tutorimi. **[3.3]** Departamentet janë përgjegjëse për procesin e mentorimit dhe tutorimit: një pedagog përzgjidhet si tutor/këshillues për çdo student nga departamenti përkatës dhe stafi akademik i kushton pesë orë në javë tutorimit të studentëve. **[3.3 neni 41]** Pedagogu ndjek ecurinë e studentëve gjatë gjithë periudhës së studimit dhe vepron si një “urë lidhëse” midis studentit dhe pjesës tjetër të stafit akademik ose njësisive administrative. **[M7]** Studentët plotësojnë formularët e regjistrimit dhe ua dorëzojnë pedagogëve tutorë për miratim gjatë periudhës fillestare të regjistrimit ose rinovimit të regjistrimit në një vit pasues. Tutorët luajnë rol në familjarizimin e studentëve me jetën shoqërore të Kolegjit Universitar “Logos”. **[M7]** Personeli tjetër akademik i këshillon studentët në nevojë dhe kjo ofrohet lehtësisht fal raportit të ulët staf - student. **[M3; M7]** Stafi akademik u jep ndihmë shtesë studentëve për ato tema që janë të vështira për ta dhe japin feedback-un e tyre në lidhje me pyetjet e provimit. **[M3]** Kjo përfshin feedback të përgjithshëm për të gjithë klasën, si dhe ndihmë individuale në rastet që kanë nevojë. **[M3]** Kolegji Universitar ka një procedurë transferimi për studentët të cilët dëshirojnë të ndryshojnë programin e tyre **[3.3; 3.3 neni 75]** dhe mban një regjistër të studentëve të transferuar. **[10.8; 6.10; 6.11]** Kolegji Universitar u lejon studentëve të transferohen në mes të programeve brenda të njëjtit nivel. **[3.3 neni 76] [Kapitulli I Standardi III.3]**

5.4 Kolegji Universitar ka një politikë bursash. **[3.3 neni 78]** me bursa të vlefshme për studentët e shkëlqyer, studentët në nevojë dhe për studentët me aftësi të kufizuara. Për vitin akademik 2016-2017 u dhanë 17 bursa për studentët në nevojë dhe 11 për studentë të shkëlqyer. **[<https://www.shlplogos.edu.al>; turne në vend; M3]** Vlera e bursës së ekselencës ndryshon me notat e provimeve: 50 për qind mbulim të tarifës për një notë mesatare prej 9.1-9.5; 80 për qind për një mesatare prej 9.6-9.8; dhe 100 për qind për një mesatare prej 9.8 deri në 10. **[vizita në terren]** Zyra e Financës administron bursat financiare dhe i përpunon ato përmes një programi financiar. Fondacioni Logos gjithmonë ka mbështetur veprimtaritë sociale, **[M8]** por fondet për veprimtaritë e studentëve janë të pakta **[M8]** sepse tarifat janë të ulëta (shih gjithashtu pikën 5.7 më poshtë). **[Kapitulli I Standardi III.4]**

5.5 Kolegji Universitar “Logos” ofron tekstet në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja në bibliotekën kryesore për të dy fakultetet. Rregulloret e bibliotekës përcaktojnë qartë se si studentët mund të kenë akses në bibliotekë **[3.11]** dhe bibliotekari punon me fakultetet dhe departamentet për t’u siguruar që librezat të mbahen të përditësuar. Biblioteka pranon kërkesa për libra nga departamentet dhe Senati Akademik miraton listën e librave që duhet të blihen. **[M7; M8]** Studentët e frekuentojnë më shumë bibliotekën gjatë periudhës së provimeve për shkak të qetësisë në këto ambiente. Biblioteka gjendet në katin e nëntë dhe ka një kapacitet prej 2,027 librash. Nga këto 272 janë në gjuhën angleze, 15 në gjuhën frënge, shtatë në gjuhën gjermane, pesë në gjuhën italiane dhe 1,603 në gjuhën greke; pjesa tjetër në gjuhën shqipe. **[vizita në terren M8]** Kolegji Universitar i ka kushtuar vëmendje të veçantë literaturës greke sepse do të shërbejë në fakultetin e tretë që është planifikuar të themelohet. Biblioteka nuk ka burime të librave elektronik, ndonëse është duke eksploruar marrëveshje me dy ofrues. Nuk ekziston një politikë e qartë për digjitalizimin e bibliotekës dhe institucioni preferon të vazhdojë t’i zhvillojë burimet e librave në format të shtypur. **[M8]** Ky konstatim mbështet dobësitë dhe rekomandimet e identifikuara në pikën 4.5. **[Kapitulli I Standardi III.5]**

5.6 Përveç procesit të tutorimit formal, kontakti i përditshëm me pedagogët ofron mundësi të mëtejshme për të mbështetur dhe lehtësuar përparimin e studentëve të ciklit të parë. Ofrohet mentorim i posaçëm për studentët e ciklit të parë në vitin e tretë që i mbështet studentët gjatë përzgjedhjes dhe zhvillimit të tezës së tyre dhe i këshillon për mundësitë e punësimit në të ardhmen. Në mënyrë të ngjashme, studentëve u jepet këshillim dhe udhëzime para dhe gjatë praktikës profesionale ose mundësive të fillimit të saj dhe ata shoqërohen nga një pedagog në takimin e tyre të parë me ofruesit e vendeve ku do të kryhet praktika profesionale. Kolegji Universitar gjithashtu ofron këshillim për mundësitë e studimit të ardhshëm për ata që dëshirojnë të përparojnë në programet e ciklit të dytë. **[M4, M7, dok. shtesë 3 fq.9] [Kapitulli I Standardi III.6]**

5.7 Kolegji Universitar “Logos” nxit pjesëmarrjen e studentëve në të gjitha organet menaxhuese dhe vendimmarrëse. Studentët kanë një Këshill Studentor që zgjedh anëtarët përmes një votimi të fshehtë. Studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, NjSBC dhe Bordin e Administratës, **[M3, M4, M7, M8]** dhe plotësojnë pyetësorët për përvojën e tyre në studimet e tyre, që ua shpërndan NjSBC-ja. **[dok. shtesë 5-2-1; dok. shtesë 5-2-2]** Këshilli i Studentor mblidhet kur ka çështje për t’u diskutuar, **[M3]** por ata nuk kanë një sallë të veçantë takimi. Kolegji Universitar “Logos” mbështet veprimtaritë e studentëve, por nuk siguron fonde. Komuniteti studentor është shumë aktiv dhe ka qenë i efektshëm në sigurimin e përmirësimeve në pajisjet që janë në dispozicion për studentët **[M3]** por Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron **dobësi** mungesën e mbështetjes financiare për veprimtaritë e Këshillit Studentor dhe për këtë arsye **rekomandon** që Kolegji Universitar “Logos” duhet të ofrojë mbështetje financiare për veprimtaritë e Këshillit Studentor brenda gjashtë muajve pas marrjes së raportit përfundimtar. **[Kapitulli I Standardi III.7]**

5.8 Kolegji Universitar “Logos” ndjek një politikë të efektshme dhe të përshtatshme për të siguruar cilësinë e jetës së studentëve në aspektin e veprimtarive kulturore dhe sportive. Kolegji Universitar “Logos” nuk siguron akomodim për studentët, por ka në plan ta bëjë këtë kur të ndërtohet kampusi i ri. **[planet e ofruara gjatë vizitës; M8]** Kolegji Universitar ofron një palestër, mbështet një grup futbollit në të cilin luajnë edhe pjesëtarë nga stafi **[M3]** dhe përgatit shfaqje muzikore; ZKK-ja organizoi për herë të parë në vitin 2017 një konferencë të studentëve. Si pjesë e një fushate kundër kancerit, Kolegji Universitar dhe studentët kanë mbështetur dhurimin e gjakut për fëmijët me sëmundje talasemike. **[M3, M4; M8]** Megjithatë, hapësira për veprimtaritë shoqërore të studentëve është shumë e kufizuar dhe Kolegji Universitar njuh faktin që infrastrukturën për veprimtaritë shoqërore dhe kulturore është e kufizuar. **[RVV analiza SWOT]** Kati i dhjetë po zhvillohet si një objekt argëtimi për studentët **[vizita në terren, M8]**, por ekziston rreziku që **Kapitulli 1 Standardi III.8** të mos përmbushet nëse nuk bëhet përparim prandaj dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** ristrukturimin e hapësirës në katin e dhjetë që do të përdoret për veprimtari sociale dhe kulturore për të mirën e studentëve. **[Kapitulli I Standardi III.8]**

5.9 ZKK-ja është përgjegjëse për këshillimin e studentëve për aplikimet për punë, intervistat dhe për përgatitjen e një CV-je. **[12.2; 12.6 fq.2]** Për këtë, ZKK-ja organizojnë workshop-e. Zyra përgatit marrëveshje institucionale me spitale, klinika, qendra shëndetësore, kompani financiare, banka dhe institucione shtetërore për të ofruar stazhe. **[M3; M7; M8; dok. shtesë 3.02-3.024]** Anëtarët e bordit të ZKK-së **[dok. shtesë 4-]** mbajnë marrëdhënie me partnerët dhe ndihmojnë studentët ta organizojnë stazhin dhe partnerët i dërgojnë ZKK-së informacionin në lidhje me vendet e punës që mund të jenë të përshtatshme për të diplomuarit e Kolegjit Universitar “Logos”. **[RVV fq.44]** Stafi akademik me kohë të pjesshme siguron lidhje me vendet e tyre të punës profesionale, dhe kjo i mbështet studentët ta kuptojnë botën e punës. Punëdhënësit që ofrojnë stazhin zgjedhin studentët më të motivuar si punonjës kur ata diplomohen **[M8; M6]** dhe Kolegji Universitar “Logos” vetë ka punësuar disa nga të diplomuarit e saj më të mirë. **[M7; M8]** ZKK mbledh të dhëna statistikore mbi punësimin e studentëve **[7.a; 7.b; 12-6]** dhe kohët e fundit ka ngritur një shoqatë alumnish për të përmirësuar lidhjet ndërmjet studentëve të tanishëm, të diplomuarve dhe Kolegjit Universitar. **[M8] [Kapitulli I Standardi III.9]**

5.10 Kolegji Universitar “Logos” rekruton studentët e vitit të parë përmes takimeve me nxënës të shkollave të mesme në rajone të ndryshme të Shqipërisë, përmes fushatave mediatike dhe shpërndarjes së informacionit në faqet e internetit dhe rrjetet sociale. Kolegji Universitar “Logos” mirëpret studentë të rinj dhe u jep atyre informacion rreth programit të tij të studimit. Studentët më të vjetër përkrahin të sapoardhurit dhe sistemi i pedagogëve kujdestarë u ofron të gjithë studentëve një anëtar të stafit që mund t'u ofrojë ndihmë dhe këshillim. Kjo politikë është proaktive dhe mbështetëse. Përmbajtja e programit, rregulloret për vlerësimin e studentëve dhe procesi i përgatitjes së tezës së diplomës janë të përcaktuara mirë në Rregullore. ZKK-ja është aktive në mbështetjen e studentëve për të gjetur vende pune dhe menaxhon lidhje me partnerët të cilët ofrojnë stazhe dhe praktika të tjera profesionale që rrisin mundësitë e punësimit të studentëve. Ekziston një shoqatë e re e të diplomuarve për të ndarë përvojat e të diplomuarve me studentët e tanishëm dhe të dhënat për punësimin e të diplomuarve. Ekziston një përfaqësim i gjerë i studentëve në organet vendimmarrëse dhe Këshilli Studentor është i efektshëm në përcjelljen e shqetësimeve të studentëve, megjithëse mbledhjet bëhen sipas nevojës dhe jo në mënyrë të rregullt. Kolegji Universitar “Logos” mbështet veprimtaritë sociale të studentëve, por nuk ka mbështetje financiare për këtë dhe infrastruktura për veprimtaritë sociale dhe kulturore është ende në zhvillim e sipër.

## **Gjetjet**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### **Dobësi**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e mbështetjes financiare për veprimtaritë e Këshillit Studentor (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**).

### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi rekomandimin e mëposhtëm:

- që Logos të sigurojë mbështetje financiare për aktivitetet e Këshillit Studentor brenda gjashtë muajve nga marrja e raportit përfundimtar (pika 5.7, **Kapitulli I Standardi III.7**).

### **Pohim i veprimeve të ndërmarra**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e mëposhtëm të ndërmarrë:

- ristrukturimi i hapësirës në katin e dhjetë që të përdoret për aktivitete sociale dhe kulturore për të mirën e studentëve (pika 5.8; **Kapitulli I Standard III.8**).

## **Gjykimi**

**Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.**

## Lista e dokumenteve

<b>Dokumenti 1.1</b>	Aktit i Fondacionit
<b>Dokumenti 1.2</b>	Statuti i Fondacionit
<b>Dokumenti 1.3</b>	Akti i Pronësisë së KOASH (Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë)
<b>Dokumenti 1.4</b>	Kontratat e huasë (1, 2,3)
<b>Dokumenti 1.5</b>	Vendimi i Gjykatës nr. 284, datë 26.06.2008
<b>Dokumenti 1.6</b>	Vendimi i Gjykatës nr. 284/1, datë 22.06.2011
<b>Dokumenti 2.1</b>	Vendimi nr. 1055, datë 29.07.2009 'Për licencimin e Logos PHS'
<b>Dokumenti 2.2</b>	Urdhër i MAS, nr. 396, datë 02.08.2010 "Për licencimin e tre programeve të studimit"
<b>Dokumenti 2.3</b>	Urdhër i MAS, nr. 1, datë 06.01.2011 'Për licencimin e tre programeve të studimit'
<b>Dokumenti 2.4</b>	Urdhër i Ministrit, nr. 481, datë 03/10/2011, 'Për lejimin e Logos PHS për të kryer veprimtari'
<b>Dokumenti 2.5</b>	Urdhër i MAS nr. 282, datë 04.07.2012 "Për akreditimin institucional dhe programet akademike"
<b>Dokumenti 2.6</b>	Urdhër i MAS nr. 335, datë 16.08.2013 'Për licencimin e dy programeve të ciklit të dytë'
<b>Dokumenti 2.7</b>	Urdhër i MAS nr. 342, datë 17/09/2015 "Për akreditimin e dy programeve të studimeve Master"
<b>Dokumenti 2.8</b>	Urdhër nr. 606, datë 22.12.2016, 'Për plotësimin e kërkesave të akreditimit'
<b>Dokumenti 2.9</b>	Vendimi i HECA, nr. 70/1, datë 02.11.2015, 'Për akreditimin e programeve të studimit'
<b>Dokumenti 2.10</b>	Urdhër nr. 89, datë 26.02.2016 'Për ndryshimin e emrit të një programi studimi'
<b>Dokumenti 2.11</b>	VKM Nr. 540, datë 06.08.2014 'Për pezullimin e disa aktiviteteve të institucioneve private të arsimit të lartë'
<b>Dokumenti 2.12</b>	VKM Nr. 690, datë 22.10.2014 'Për heqjen e pezullimit të Logos PHS'
<b>Dokumenti 3.1</b>	Statuti i Logos PHS
<b>Dokumenti 3.2</b>	Plani Strategjik për Zhvillimin e Logos PHS - prioritetet dhe synimet për 2012-2017
<b>Dokumenti 3.3</b>	Rregulloret e Përgjithshme
<b>Dokumenti 3.4</b>	Rregulloret e Fakultetit të Ekonomikut
<b>Dokumenti 3.5</b>	Rregulloret e Programit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet
<b>Dokumenti 3.6</b>	Manuali i Politikave dhe Procedurave të Logos PHS në zbatimin e misionit dhe qëllimeve të tij
<b>Dokumenti 3.7</b>	Plani i Marketingut – kërkimi i tregut për programet e studimit të ciklit të parë
<b>Dokumenti 3.8</b>	Procedurat për menaxhimin e informacionit
<b>Dokumenti 3.9</b>	Rregulloret e Zyrës së Regjistrimit
<b>Dokumenti 3.10</b>	Rregulloret e Zyrës së Financave
<b>Dokumenti 3.11</b>	Rregulloret e bibliotekës dhe bashkëpunimi online me Bibliotekën e Pireut
<b>Dokumenti 3.12</b>	Rregulloret e programeve të Masterit Profesional
<b>Dokumenti 4.1</b>	Përbërja e Senatit - vendimi
<b>Dokumenti 4.2</b>	Përbërja e Rektoratit - vendimi
<b>Dokumenti 4.3</b>	Përbërja e Zyrës së Dekani - vendim
<b>Dokumenti 4.4</b>	Përbërja e Departamentit - vendimi
<b>Dokumenti 4.5</b>	Struktura organizative e institucionit (1,2)
<b>Dokumenti 5.1</b>	Raporti Vjetor i Institucionit për 2013-2014

<b>Dokumenti 5.2</b>	Përmirësimi i praktikave për teknikun e lartë në programin e laboratorëve mjekësorë
<b>Dokumenti 5.3</b>	Planet dhe programet e studimeve për programet e ciklit të parë (Bachelor) në:
	a) Financë dhe Kontabilitet,
	b) Teknik i Lartë në Laboratorët Mjekësorë
	c) Dokumentet shitesë
<b>Dokumenti 5.4</b>	Planet dhe programet e studimit për programet e ciklit të dytë (Master Profesional) në:
	d) Financimi dhe Kontabilitet,
	e) Teknikët e Lartë në Laboratorin Mjekësor
	f) Dokumentet shitesë
<b>Dokumenti 5.5</b>	Formati i Diplomës
<b>Dokumenti 6.1</b>	Ngarkesa mësimore e stafit akademik, 2015-2016
<b>Dokumenti 6.2</b>	Të dhënat për rekrutimin dhe largimin e stafit
<b>Dokumenti 6.3</b>	Statistikat për stafin me kohë të plotë dhe kualifikimet e tyre
<b>Dokumenti 6.4</b>	Statistikat për stafin me kohë të pjesshme dhe kualifikimet e tyre
<b>Dokumenti 6.5</b>	Të dhëna për kualifikimet e stafit akademik
<b>Dokumenti 6.6</b>	Ngarkesa e planifikuar e Fakultetit të Ekonomikut për 2016-2017
<b>Dokumenti 6.7</b>	Aktivitetet e planifikuara të stafit akademik për 2016-2017, Fakulteti Ekonomik
<b>Dokumenti 6.8</b>	Orari i mësimdhënies për programet Master Profesional
<b>Dokumenti 6.9</b>	Rezultatet dhe listat e notave të provimeve të studentëve
<b>Dokumenti 6.10</b>	Vendimi i Senatit nr. 7, datë 27.10.2014 'Për miratimin e vlerësimit të grupit të punës për transferimin e studentëve, Fakulteti i Ekonomikut.
<b>Dokumenti. 6.11</b>	Vendimi i Komisionit nr. 7/3, datë 04.11.2014 'Për unifikimin dhe njësimin të programeve të studimit (shembull, Fakulteti Ekonomik)'
<b>Dokumenti 6.12</b>	Kontrata e punësimit me kohë të plotë
<b>Dokumenti 6.13</b>	Kontrata e punësimit me kohë të pjesshme
<b>Dokumenti 6.14</b>	Praktikat e Rekrutimit
<b>Dokumenti 6.15</b>	Jeta shoqërore e institucionit
<b>Dokumenti 6.16</b>	Vlerësimi i performancës së stafit akademik
<b>Dokumenti 7.1</b>	Vendimi i Senatit për themelimin e Qendrës Kërkimore Shkencore
<b>Dokumenti 7.2</b>	Rregullore e Qendrës Kërkimore Shkencore
<b>Dokumenti 7.3</b>	Vendimi i Senatit për miratimin e rregulloreve të Qendrës Kërkimore Shkencore
<b>Dokumenti 7.4</b>	Programi i kërkimit shkencor për 2014-2015
<b>Dokumenti 7.5</b>	Raporti i kërkimit shkencor të Fakultetit të Ekonomikut, 2014-2015
<b>Dokumenti 7.6</b>	Raporti përfundimtar për veprimtaritë shkencore 2015-2016
<b>Dokumenti 7.7</b>	Vendimi i Senatit për lektorët e ftuar
<b>Dokumenti 7.8</b>	Punimet e paraqitura në leksionet e hapura
<b>Dokumenti 7.9</b>	Për ekspertizën dhe bashkëpunimin e stafit akademik
<b>Dokumenti 7.10</b>	Revista shkencore Logos Nr. 1
<b>Dokumenti 7.11</b>	Projektet e fituara (nr. 1, nr. 2)
<b>Dokumenti 7.12</b>	Konferenca Ndërkombëtare Shkencore më 17 mars 2017
<b>Dokumenti 8.1</b>	Vendimi i Senatit nr. 12/2, datë 16.11.2015, për funksionimin e NjSBC-së
<b>Dokumenti 8.2</b>	Strategjia për zhvillimin dhe kontrollin e cilësisë
<b>Dokumenti 8.3</b>	Metodologjia e vlerësimit
<b>Dokumenti 8.4</b>	Krijimi i NjSBC-së i Fakultetit të Ekonomikut
<b>Dokumenti 8.5</b>	Detyrat dhe përgjegjësitë e NjSBC-së në Fakultetin e Ekonomikut
<b>Dokumenti 8.6</b>	Raport i veprimtarisë së NjSBC-së në Fakultetin Ekonomik në 2015-2016
<b>Dokumenti 8.7</b>	Informacion nga NjSBC-ja për rezultatet e pyetësorit për diplomat Bachelor, Fakulteti Ekonomik

<b>Dokumenti 8.8</b>	Analiza e pyetësorëve për programet Master Profesional, Fakulteti Ekonomik
<b>Dokumenti 8.9</b>	Informacion i NjSBC-së për monitorimin e grupeve të regjistrit
<b>Dokumenti 8.10</b>	Informacion i NjSBC -së për monitorimin e tezave të provimit
<b>Dokumenti 8.11</b>	Informacion i NjSBC -së për rezultatet e studentëve
<b>Dokumenti 8.12</b>	Informacion i NjSBC -së për zhvillimin e procesit të provimit
<b>Dokumenti 9.1</b>	Vendimi i Senatit për ngritjen e “Këshillit të Etikës”
<b>Dokumenti 9.2</b>	Vendimi i Senatit për miratimin e “Kodit të Etikës”
<b>Dokumenti 9.3</b>	Kodi Etik i Logos PHS
<b>Dokumenti 9.4</b>	Raport për zbatimin e “Kodit të Etikës”
<b>Dokumenti 10.1</b>	Vendimi i Rektoratit për miratimin e tarifave të shkollimit për ciklin e parë
<b>Dokumenti 10.2</b>	Vendimi i Rektoratit për miratimin e tarifave të shkollimit për ciklin e dytë
<b>Dokumenti 10.3</b>	Vendimi i Rektoratit për dhënien e bursave të studentëve për 2013-2014
<b>Dokumenti 10.4</b>	Kategoritë e bursave të studentëve për vitin 2016-2017
<b>Dokumenti 10.5</b>	Statistikat e studentëve
<b>Dokumenti 10.6</b>	Statistikat e diplomave të lëshuara
<b>Dokumenti 10.7</b>	Studentët nga rajonet shqiptare
<b>Dokumenti 10.8</b>	Studentët e transferuar
<b>Dokumenti 10.9</b>	Regjistri i notave të studentëve
<b>Dokumenti 10.10</b>	Regjistri i të dhënave të studentëve
<b>Dokumenti 10.11</b>	Regjistri i diplomave
<b>Dokumenti 10.12</b>	Të dhëna për punësimin e të diplomuarve
<b>Dokumenti 10.13</b>	Kërkesë për kompaninë Jumbo për punësimin e studentëve
<b>Dokumenti 10.14</b>	Kontratat e shërbimit të studentëve
<b>Dokumenti 10.15</b>	Programi për konferencën e studentëve
<b>Dokumenti 10.16</b>	Udhëzuesi i studentëve
<b>Dokumenti 10.17</b>	Fletëpalosje
<b>Dokumenti 11.1</b>	Programi i stazhit për Programin Bachelor në Menaxhim Biznesi
<b>Dokumenti 11.2</b>	Programi i stazhit për Bachelor në Menaxhim Turizmi
<b>Dokumenti 11.3</b>	Programi stazhit për Bachelor në Kontabilitet, Financë
<b>Dokumenti 11.4</b>	Vlerësimi i praktikës profesionale në programet e ciklit të parë
<b>Dokumenti 11.5</b>	Programi i mësimdhënies për Masterin Profesional në Financë dhe Kontabilitet
<b>Dokumenti 11.6</b>	Vlerësimi i praktikës së mësimdhënies për programet Master Profesional
<b>Dokumenti 11.7</b>	Të dhënat për praktikantët - lëndët dhe studentët
<b>Dokumenti 11.8</b>	Marrëveshjet me bizneset
<b>Dokumenti 11.9</b>	Kontratat e bashkëpunimit me IMB dhe certifikatën
<b>Dokumenti 12.1</b>	Vendimi i Senatit nr. 5/1, datë 08.09.2014, për themelimin e ZKK
<b>Dokumenti 12.2</b>	Rregullorja e ZKK-së dhe Vendimi i Senatit nr. 13/1, datë 13.01.2015, për miratimin e Rregullores së ZKK-së
<b>Dokumenti 12.3</b>	Informacion për senatorët dhe studentët e shkëlqyer, Fakulteti Ekonomik
<b>Dokumenti 12.4</b>	Vendimi i Dekanatit “Për zgjedhjen e tutorëve për grupet e studentëve”
<b>Dokumenti 12.5</b>	Raporti për veprimtaritë e ZKK-së për vitin akademik 2014-2015
<b>Dokumenti 12.6</b>	Të dhëna për punësimin e të diplomuarve
<b>Dokumenti 12.7</b>	Organizimi i tureve në shkollat e mesme për këshillimin e studentëve të ardhshëm
<b>Dokumenti 12.8</b>	Veprimtaritë sportive dhe kulturore
<b>Dokumenti 12.9</b>	Certifikatat e të diplomuarve të punësuar në Logos
<b>Dokumenti 13.1</b>	Pasqyrat Financiare për vitin 2015
<b>Dokumenti 13.2</b>	Raporti i audituesve të pavarur për pasqyrat financiare të vitit 2015
<b>Dokumenti 13.3</b>	Analiza e kostove dhe të ardhurave për vitin 2014
<b>Dokumenti 13.4</b>	Konfirmimi i NjSBC-së, datë 07.02.2017 'Për garancinë financiare të Logos'
<b>Dokumenti 13.5</b>	Broshura Shëndetësore për personelin (Shembull)



<b>Dokumenti 13.6</b>	Deklarata e inventarit
<b>Dokumenti 14.1</b>	Normat e plotësimit të formularit teknik
<b>Dokumenti 14.2</b>	Formularët për mbrojtjen nga zjarri
<b>Dokumenti 14.3</b>	Formularët për lejen sanitare higjienike
<b>Dokumenti 14.4</b>	Raport i vlerësimit të standardeve të infrastrukturës
<b>Dokumenti 15.1</b>	Urdhri i Ministrit nr. 350, datë 16.11.2000 “Për lejen e punës së Institucionit të Frymës së Dashurisë”
<b>Dokumenti 15.2</b>	Vendimi i Senatit për hapjen e një fakulteti të ri
<b>Dokumenti 15.3</b>	Dokumente drejtuar MAS-it për hapjen e një fakulteti të ri

#### Dokumente shitesë të kërkuara

<b>Dokumenti shitesë 1</b>	Numrat e studentëve
<b>Dokumenti shitesë 2a</b>	Bordi i Administrimit
<b>Dokumenti shitesë 2b</b>	Procesverbali i mbledhjes së Senatit
<b>Dokumenti shitesë 2c</b>	Dhënia e bursave
<b>Dokumenti shitesë 3a</b>	Raport vjetor 2015-2016 - dorëzimi
<b>Dokumenti shitesë 3</b>	Raport vjetor 2015-2016
<b>Dokumenti shitesë 4a</b>	Plani strategjik - deklarimi
<b>Dokumenti shitesë 4b</b>	Vendimi i Senatit
<b>Dokumenti shitesë 5.2.1</b>	Përmirësimet në programin e teknikut të laboratorit mjekësor
<b>Dokumenti shitesë 5.2.2</b>	Ndryshimet e programeve
<b>Dokumenti shitesë 6a</b>	Kërkimi i tregut
<b>Dokumenti shitesë 6b</b>	Analiza e tregut të punës
<b>Dokumenti shitesë 7a</b>	Analiza e tregut të punës - teknike të laboratorëve mjekësorë
<b>Dokumenti shitesë 7b</b>	Punësimi i studentëve
<b>Dokumenti shitesë 8</b>	Praktika profesionale
<b>Dokumenti shitesë 9</b>	Raporti i kërkimit shkencor 2014-2015
<b>Dokumenti shitesë 9</b>	Raporti i kërkimit shkencor 2015-2016
<b>Dokumenti shitesë 11.4</b>	Programi i Praktikës
<b>Dokumenti shitesë 11.5</b>	Dokumentacioni i stazhit (1)
<b>Dokumenti shitesë 11.6</b>	Dokumentacioni i stazhit (2)
<b>Dokumenti plotësues. 11.7</b>	Vendndodhja e praktikës
<b>Dokumenti shitesë 11a</b>	Kontabilitet i kompjuterizuar - 2014
<b>Dokumenti shitesë 11b</b>	Kontabilitet i kompjuterizuar - IMB
<b>Dokumenti shitesë 11c</b>	Kontabilitet i kompjuterizuar - 2016
<b>Dokumenti shitesë 11d</b>	Marrëveshje BMI
<b>Dokumenti shitesë X1</b>	Shënim: faqja 40 e RVV
<b>Dokumenti shitesë X2</b>	Shënim për analizën e tregut
<b>Dokumenti shitesë X3</b>	Udhëzimi i studentit

#### Dokumentet e ofruara gjatë vizitës

<b>Dokumenti V1</b>	Planet për kampusin e ri
<b>Dokumenti V2</b>	Kopje e printuar e udhëzimit për studentët
<b>Dokumenti V3</b>	Të dhëna e ZKK-së për punësimin e të diplomuarve
<b>Dokumenti V4</b>	Shoqata Alumni
<b>Dokumente V5</b>	Anketimi i studenteve për pedagogët
<b>Dokumenti V6</b>	Marrëveshja me Universitetin e Pireut

## Mbledhjet

<b>M1</b>	Mbledhje1 Rektori
<b>M2</b>	Mbledhje 2 Stafi i lartë drejtues
<b>M3</b>	Mbledhje 3 Studentët e ciklit të parë
<b>M4</b>	Mbledhje 4 Studentët e ciklit të dytë
<b>M5</b>	Mbledhje 5 Grupi që ka përgatitur RVV-në
<b>M6</b>	Mbledhje 6 Punëdhënësit, partnerët dhe alumni
<b>M7</b>	Mbledhje 7 Stafi akademik
<b>M8</b>	Mbledhje 8 Personeli mbështetës
<b>M9</b>	Mbledhje 9 Rektori